



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Nr. 49/5 Prot.

Tiranë, më 30/10/2020

Miratohet

**K R Y E T A R**

**ARBEN SHEHU**

Raport Përfundimtar  
Auditimi Performance  
“EFICIENCA E ENERGJISË”



## ◊ PËRMBAJTJA

<b>1. RËNDËSIA E AUDITIMIT .....</b>	<b>5</b>
<b>1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL.....</b>	<b>5</b>
<b>1.2 STRATEGJIA E KLSH-SË NË AUDITIMET E PERFORMANCËS.....</b>	<b>9</b>
<b>1.3 AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË .....</b>	<b>9</b>
<b>1.4 SUBJEKTI NËN AUDITIM.....</b>	<b>10</b>
<i>1.4.1 Hyrje.....</i>	<i>13</i>
<i>1.4.2 Politikat e Institucionit/Agjencisë.....</i>	<i>14</i>
<i>1.4.3 Pesha në buxhet.....</i>	<i>15</i>
<i>1.4.4 Risqet e aktiviteteve të subjekteve .....</i>	<i>18</i>
<i>1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit.....</i>	<i>22</i>
<i>1.4.6 Feedback-u i subjektit.....</i>	<i>22</i>
<b>2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT.....</b>	<b>23</b>
<b>2.1 OBJEKTIVI DHE PROBLEMI I PERFORMANCËS .....</b>	<b>23</b>
<i>2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit .....</i>	<i>23</i>
<i>2.1.2 Objektivi i auditimit.....</i>	<i>25</i>
<b>2.3 BURIME TË KRITEREVE .....</b>	<b>27</b>
<i>2.3.1 Kriteret politike .....</i>	<i>27</i>
<i>2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit.....</i>	<i>27</i>
<i>2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit.....</i>	<i>28</i>
<i>2.3.2 Kriteret e tjera.....</i>	<i>28</i>
<b>2.4 PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE .....</b>	<b>29</b>
<b>2.5 QASJA/METODOLOGJIA E AUDITIMIT .....</b>	<b>30</b>
<i>2.5.1 Metodatat/teknikat audituese.....</i>	<i>30</i>
<b>2.6 REZULTATET E PARASHIKUARA .....</b>	<b>30</b>
<i>2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë.....</i>	<i>31</i>
<i>2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit.....</i>	<i>31</i>
<i>2.6.3 Forma e publikimit.....</i>	<i>31</i>
<b>3. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE.....</b>	<b>32</b>
<b>4. PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>68</b>
<b>5. GRUPI I PUNËS DHE PËRGJEGJËSITË HIERARKIKE .....</b>	<b>ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.</b>

## LISTA E SKEMAVE DHE TABELAVE

<b>Skema 1:</b> Përfitimet nga Politikat e Eficiencës së Energjisë .....	8
<b>Skema 2:</b> Ndërveprimi i aktorëve për të siguruar përdorim eficient të energjisë në ndërtesa	10
<b>Skema 3:</b> Organigrama e pjesshme e MIE.....	13
<b>Skema 4:</b> Organigrama e AEE .....	14
<b>Skema 5:</b> Modeli Input - Output .....	24
<b>Tabela 1:</b> Pesha që zë programi “Mbështetje për Energjinë” në buxhetin e MIE.....	15
<b>Tabela 2:</b> Pesha që zë programi “Mbështetje për Energjinë” në buxhetin e shtetit .....	16
<b>Tabela 3 :</b> Investimet në sektorin publik për EE 2018–2030 .....	16
<b>Tabela 4:</b> Buxhetet e planifikuara për EE kundrejt atyre të planifikuara për sektorin e energjisë .....	17
<b>Tabela 5:</b> Fondet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara për eficiencën e energjisë .....	18
<b>Tabela 6:</b> Analiza SWOT .....	19
<b>Tabela 7:</b> PESTLE.....	19
<b>Tabela 8 :</b> Buxheti i nevojshëm për zbatimin e masave në EE sipas SKE 2018-2030, buxheti i planifikuar dhe ai i alokuar.....	47
<b>Tabela 9</b> Fondet e alokuara për AEE kundrejt fondeve të nevojshme.....	49
<b>Tabela 10</b> Instrumentet financiare për nxitjen e investimeve në EE dhe aplikimi i tyre në Shqipëri.....	55
<b>Tabela 11</b> Përmbledhje e masave të EE – Bashkia Vlorë.....	59
<b>Tabela 12</b> Përmbledhje e masave të EE – Bashkia Gjirokastër.....	60
<b>Tabela 13</b> Përmbledhje e masave të EE – Bashkia Korçë.....	61

✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>AEE</b>	Agjencia e Eficiencës së Energjisë
<b>ANE</b>	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>EED</b>	Direktiva e Eficiencës së Energjisë <i>(Energy Efficiency Directive)</i>
<b>EE</b>	Eficienca e Energjisë
<b>3E</b>	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
<b>Fondi EE</b>	Fondi për Eficiencën e Energjisë
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>MIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>OBSH</b>	Organizata Botërore e Shëndetësisë
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit <i>(The International Organisation of Supreme Audit Institutions)</i>
<b>PKVEE</b>	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit <i>(International Standards of Supreme Audit Institutions)</i>
<b>SKE</b>	Strategjia Kombëtare e Energjisë
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## 1. RËNDËSIA E AUDITIMIT

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Misioni i KLSH-së në Strategjinë e Zhvillimit 2018 - 2022<sup>1</sup> kërkon që si institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që t'i shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit. Strategjia, duke u bazuar në arritjet e Planit të mëparshëm Strategjik 2013 - 2017, vijon të menduarit strategjik dhe profesional, duke përcaktuar objektiva dhe plan pune, duke vepruar ndaj ndryshimeve të mjedisit dinamik ku vepron institucioni, për manaxhimin sa më të suksesshëm të sfidave dhe risqeve. Ky proces realizohet duke ruajtur vlerat dhe parimet e një institucioni suprem auditimi, të sanksionuara në Deklaratën e Limës, Magna Carta e SAI - ve, si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.<sup>2</sup>

Tema e përzgjedhur ka për qëllim të paraqes një studim mbi efektivitetin e veprimeve të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse me synim, zvogëlimin e konsumit të energjisë në ndërtesa. Me rritjen e mirëqenies sociale dhe shtimit të pajisjeve elektrike në banesa, konsumi i energjisë ka patur rritje nga viti në vit dhe pjesa më e madhe e kësaj energjie konsumohet për ngrohjen e banesave. Për reduktimin e konsumit dhe shpenzimeve të energjisë, dhe për të përmirësuar ambjentin e brendshëm, është e nevojshme të rinovohet dhe zbatohen masat për eficiencën e energjisë në ndërtesa. Të ndërtosh një ndërtesë eficiente presupozon projektimin, procesin e ndërtimit të ndërtesës së re të termoizoluar dhe izolimin e asaj ekzistuese<sup>3</sup>. Kursimi energjistik përbën një nga kushtet themelore për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe gjithashtu mbetet një prej politikave të detyrueshme për vendet që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit Evropian. Rëndësia e këtij auditimi qëndron në pasqyrimin e gjendjes aktuale në fushën e Eficiencës së Energjisë, si dhe në kontribuimin në përmirësimin e këtij shërbimi nëpërmjet gjenerimit të rekomandimeve përfundimtare. Nëpërmjet këtij auditimi KLSH synon t'i ofrojë taksapaguesve një raportim të besueshëm, të pavarur dhe objektiv mbi efektivitetin e veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi dhe efektivitetit të eficiencës së energjisë duke e krahasuar me praktikat më të mira ndërkombëtare, si një prioritet thelbësor për mirëqenien e qytetarëve.

### 1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Përmirësimet në eficiencën e energjisë japin mundësinë që të sjellin përfitime afat-gjata sociale, ekonomike dhe mjedisore. Duke përdorur energjinë në mënyrë më eficiente, bizneset bëhen më konkurruese dhe familjet paguajnë fatura më të ulëta për energjinë.

---

<sup>1</sup> Miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 229, datë 31.12.2017 “Për Miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH- së për Periudhën 2018 – 2022”.

<sup>2</sup> Nga “Mesazhi i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018 – 2022, faqe 4.

<sup>3</sup> <http://akbn.gov.al/images/informacion/Eficienta/brochura%20final.pdf>

Sot, ekzistojnë kosto dhe përfitime social-ekonomike afat-shkurtra që vijnë nga investimet e masave të marra për eficiencën e energjisë. Dikush duhet të paguajë për investimet e kërkuara për të përmirësuar ndërtesat apo pajisjet energjitike. Aktivitetet e stimuluar nga ky investim për të përmirësuar eficiencën e energjisë janë shpesh mjaft intensive dhe mund të ofrojnë një nxitje afatshkurtër për punësimin lokal, veçanërisht në disa sektorë të veçantë si për shembull ndërtimi. Është konstatuar se në Evropë, në mënyrë të vazhdueshme familjet nuk marrin iniciativa për të përmirësuar eficiencën e energjisë, edhe kur këto opsione janë me kosto efektive ose kanë një periudhë të shkurtër shlyerje. Sigurisht kjo mungesë initiative ka shkaqe të ndryshme të cilat përfshijnë mungesën e informacionit, eksternalitetet që shfaqen kur banorët nuk janë pronarë dhe kanë kufizime në marrjen e kredive etj.<sup>4</sup>

Një studim i kryer në Poloni ka analizuar gjithashtu efektet neto, duke përdorur analizën input-output.<sup>5</sup> Ai ka përcaktuar tre lloje të efekteve të shkaktuara: ato të gjeneruara nga punësimi shtesë të krijuara nga investimet në sektorin e ndërtimit, vendet e punës të humbura në sektorin e energjisë si rezultat i kërkesës në ulje të energjisë, dhe ndikimet e shkaktuara nga shpenzimet monetare që rezultojnë nga kursimi i energjisë së përdorur.<sup>6</sup> Në përgjithësi, studimi vlerëson se 86,000 deri në 254,000 vende pune shtesë në vit mund të gjenerohen në vitin 2020, në varësi të intensitetit dhe thellësisë së skenarëve të rinovimit të ndërtesave.<sup>7</sup> Një studim i kohëve të fundit i Këshillit Amerikan për një ekonomi me Eficiencë Energjetike (American Council for an Energy Efficient Economy - ACEEE) zbuloi se investimet në eficiencën e energjisë krijojnë vende pune veçanërisht në sektorin e ndërtimit, në rinovimin dhe instalimin e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë në ndërtesa. Një investim 1 milion dollarë mbështet mesatarisht krijimin e 20 vendeve pune të reja. Afërsisht rreth 900,000 vende pune u krijuan në vitin 2010 në 28 shtetet anëtare të BE-së nga shitja e mallrave dhe shërbimeve të eficiencës së energjisë.<sup>8</sup> Eficienca e energjisë mund të ndihmojë gjithashtu në uljen e faturave të energjisë së konsumatorëve. Departamenti i Energjisë dhe Ndryshimit të Klimës në Mbretërinë e Bashkuar (UK Department of Energy and Climate Change – DECC) ka llogaritur për vitin 2013 se pasi u morën në konsideratë politikat e eficiencës së energjisë u arrit në një kursim neto prej 5 % të energjisë së përdorur krahasuar me energjinë që do të ishte përdorur nëse nuk do të merreshin parasysh këto politika.<sup>9</sup>

Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019 në Kapitullin e 15-të “Energjia” thekson *kursimin e energjisë me 6.8 % të energjisë së përdorur në Shqipëri deri në vitin 2020 si objektivin kryesor të PKVEE 2017-2020. Agjencia e Eficiencës së Energjisë e krijuar në vitin 2016 për të zbatuar politikat dhe masat e eficiencës së*

---

<sup>4</sup> Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, Cambridge Econometrics 2015, fq 13.

<sup>5</sup> Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, Cambridge Econometrics 2015, fq 17

<sup>6</sup> Ky efekt i referohet kryesisht përdoruesit fundor të energjisë i cili duke kursyer para nga kursimi i energjisë mund t'i përdorë ato për qëllime të tjera.

<sup>7</sup> Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, Cambridge Econometrics 2015, fq 17.

<sup>8</sup> Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, Cambridge Econometrics 2015, fq 38.

<sup>9</sup> Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, Cambridge Econometrics 2015, fq 19.

*energjisë, aktualisht nuk ka stafin e përshtatshëm dhe nuk është funksionale. Shqipëria duhet të fillojë të ndryshojë Ligjin e Eficiencës së Energjisë për ta përshtatur me Direktivën e Eficiencës së Energjisë (EED). Ligji mbi performancën e energjisë në ndërtesat hyri në fuqi në vitin 2016 por Shqipëria ende duhet të miratojë legjislacionin e nevojshëm për të arritur përputhjen e plotë me “acquis” në këtë fushë.<sup>10</sup>*

Studime të ndryshme theksojnë përfitime të përbashkëta sociale e mjedisore nga efienca e energjisë. Për shembull, bazuar në një vlerësim të efekteve ekonomike nga përmirësimet në eficiencën e energjisë në stokun e ndërtesave në Finlandë, u identifikuan rënie të theksuara të emetimeve të ndotësve të rrezikshëm dhe gazeve serë. Ekzistojnë gjithashtu dëshmi paraprake (bazuar në konsultimet me OBSH dhe ANE<sup>11</sup>) që sugjerojnë se përmirësimet në eficiencën e energjisë çojnë në reduktim të ndotjes së ajrit dhe në rastin e ristrukturimit të ndërtesave në një klimë të brendshme më të mirë si rezultat i uljes së lagështisë dhe përmirësimit të cilësisë së ajrit të brendshëm. Përfitimet e shtëpive me eficiencë energjie shkojnë përtej reduktimit të emetimeve të karbonit dhe argumenteve të sigurisë së energjisë; efienca e energjisë mund të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve. Masat për rritjen e eficiencës së energjisë synojnë të minimizojnë sasinë totale të energjisë që duhet për të ngrohur një shtëpi. Duke pasur parasysh provat që lidhin shtëpitë e ftohta me shëndetin e dobët, rrjedh se masat e marra lidhur me eficiencën e energjisë duhet të kenë një ndikim pozitiv në shëndet. Ndikimet e drejtpërdrejta shëndetësore të të jetuarit në një shtëpi të ftohtë mund të sjellin rrezik më të lartë të vdekshmërisë dhe rritje të shkallës së sëmundshmërisë. Ekziston një dëshmi e fortë që përshkruan lidhjen midis niveleve të larta të vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë në dimër me temperaturat e ftohta.<sup>12</sup> Varfëria energjetike dhe mungesa e ngrohjes së përshtatshme të ndërtesave janë gjithashtu të dëmshme për shëndetin mendor, përmes stresit financiar që u shkakton familjeve. Varfëri energjetike është situata në të cilën një familje nuk mundet të aksesojë shërbimet energjetike në shtëpi në një nivel të atillë që mund të përballojë nevojat e saj sociale dhe materiale. Levat që përcaktojnë nëse jemi ose jo në varfëri energjetike janë: efienca e energjisë në ndërtesa, kostoja e energjisë dhe të ardhurat familjare. Për këtë arsye në vendet e Evropës, varfëria energjetike i referohet në mënyrë të përgjithshme situatës ku individët nuk janë në gjendje të sigurojnë energjinë e nevojshme në banesë me një çmim të përballueshëm. Koncepti është i fuqishëm dhe analizon tre shtylla të rëndësishme: politikat e energjisë, politikat sociale dhe praktikrat e eficiencës së energjisë.<sup>13</sup>

Efektet shëndetësore që vijnë si pasojë e banimit në mjedis të ftohtë janë sëmundjet e qarkullimit të gjakut, problemet e frymëmarrjes dhe shëndeti mendor. Situata të tjera të ndikuara nga banimi në mjedis të ftohtë përfshijnë gripin e zakonshëm dhe të ftohtin, si dhe artritin dhe reumatizmat. Nivelet më të larta të sëmundshmërisë çojnë natyrshëm në rritjen e niveleve të vdekshmërisë. Referuar 2011, në të gjithë Evropën kishte rreth 250,000 vdekje të tepërta dimri çdo vit. Nga këto, rreth 30% janë të lidhura

<sup>10</sup> Progres - Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2019, fq. 75.

<sup>11</sup> ANE – Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë (International Energy Agency – IEA)


<sup>12</sup> Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, Cambridge Econometrics 2015, fq. 129.

<sup>13</sup> Raport - Vlerësimi i performancës së energjisë në ndërtesa përmes konceptit të varfërisë energjetike, Qendra mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (Qendra EDEN), 2018.

drejtpërdrejt me jetesën në mjedise të ftohta (OBSH, 2011). Jetesa në shtëpi të ftohta sjell gjithashtu ndikime negative mendore, duke rritur ankthin dhe depresionin. Një studim nga *Shelter* (2006) tregoi se fëmijët që jetojnë në shtëpi të ftohta janë më të predispozuar të kenë probleme mendore dhe janë pesë herë më pak të lumtur në familjet e tyre se sa fëmijët që jetojnë në shtëpi të ngrohta. Efekte shëndetësore të njëjta janë verejtur edhe tek të rriturit. Dëshmitë nga vlerësimi i Programit “*Warm Front*” zbuluan se jetesa në një mjedis të ngrohtë është e lidhur me një shëndet të konsiderueshëm më të mirë mendor. Studimi tregoi se ndërsa temperatura mesatare e dhomës së gjumit u rrit, shanset e banorëve që të shmangin depresionin u rritën. Banorët me temperatura të dhomës së gjumit në 21° C kanë 50% më pak të ngjarë të pësojnë depresion apo ankth sesa ata me temperaturë 15° C (Green and Gilbertson, 2008).

Megjithatë, masat e marra për rritjen e eficiencës së energjisë mund të kenë edhe ndikime negative shëndetësore. Programi “*Warm Front*” tregoi se shumica e pjesëmarrësve që vuanin nga problemet e frymëmarrjes raportuan përmirësime në frymëmarrje, megjithatë një pjesë e vogël por e rëndësishme kishin perceptimin se sistemet e reja të ngrohjes përkeqësuan kushtet e tyre të frymëmarrjes (Green and Gilbertson, 2008). Për më tepër, ventilimi i pamjaftueshëm në shtëpitë gjithnjë e në rritje hermetike mund të çojë në rritje të niveleve të ndotësve të brendshëm si: radoni, monoksidi i karbonit, dioksidi i azotit, dhe formaldehidi, duke qenë se lagështia relative më e lartë mund të nxisë rritjen e merimangave, të mykut dhe pluhurit, të cilat ndikojnë në zhvillimin dhe përkeqësimin e astmës (Bone et al, 2010). Rreziku i mbinxehjes, i shkaktuar nga një izolim i tepërt, është një shqetësim i vazhdueshëm.<sup>14</sup>

**Skema 1:** Përfitimet nga Politikat e Eficiencës së Energjisë



Burimi: Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, 2015

<sup>14</sup> Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, Cambridge Econometrics 2015, fq. 130.

## **1.2 STRATEGJIA E KLSH-SË NË AUDITIMET E PERFORMANCËS**

Kontrulli i Lartë i Shtetit, në kuadër të objektivave të parashtruara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit (ISSAI) dhe praktikave më të mira evropiane, si një ndër sfidat kryesore të tij ka përcaktuar shtimin e numrit të auditimeve të performancës dhe përmirësimin e cilësisë së këtyre auditimeve.

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100 & 3200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas eksperiencës britanike dhe praktikat më të mira audituese në Evropë, të cilët shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance.

Kontrulli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuar në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022 për auditimet e performancës, si: *fokusimi në çështje makro-ekonomike, krahas atyre mikro-ekonomik apo fokusimi në auditime procesi më shumë sesa auditime institucioni*<sup>15</sup>, etj., KLSH ndërmori auditimin "Eficienca e Energjisë", në fushën e Energjisë. Si një çështje me ndikim të rëndësishëm në rimëkëmbjen dhe forcimin e financave të sektorit, KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me përdorimin eficient të energjisë në vend, masat e ndërmarra në këtë drejtim nga strukturat përgjegjëse dhe kursimin e arritur, si dhe të japë rekomandime për të përmirësuar aty ku është e mundur.

## **1.3 AUDITIME TË MËPARSHME NË KËTË FUSHË**

Nga KLSH është kryer në vitin 2015, edhe pse jo i lidhur drejtpërdrejt me "Eficiencën e Energjisë", një auditim performance me temë:

- "Burimet Alternative të Energjisë në Shqipëri". Ky auditim u krye bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit sipas shkresës nr. 904/1, dt. 19.01.2015 në subjektet Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Ky

---

<sup>15</sup> Strategjia e Zhvillimit Institucional 2018-2022 KLSH, Fq. 39

raport auditimi është miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 113, datë 09/09/2015.<sup>16</sup>

## 1.4 SUBJEKTI NËN AUDITIM

Identifikimi i autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse, si dhe i rolit dhe aktiviteteve që ato kryejnë për të siguruar përdorimin eficient të energjisë është mjaft i rëndësishëm, veçanërisht në fushën e EE e cila shfaqet jo e zhvilluar në vendin tonë. Grupi i auditimit ka paraqitur në vijim, ndërveprimin midis aktorëve dhe strukturave përgjegjëse për të siguruar përdorimin eficient të energjisë në ndërtesa.

**Skema 2:** Ndërveprimi i aktorëve për të siguruar përdorim eficient të energjisë në ndërtesa.

### **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:**

- ✓ Harton politikat kombëtare për eficientë e energjisë;
- ✓ Monitoron zbatimin e politikave.



### **Agjencia për Eficiencën e Energjisë:**

- ✓ Zbaton politikat dhe nxit masat për EE.
- ✓ Menaxhon bazën e të dhënave për energjinë.



- ✓ **Ndërtesat** duhet të pajisen me *Certifikatë*.
- ✓ *Certifikata* është e vlefshme për 10 vjet.

### **Audituesit energjetikë:**

- ✓ Kryejnë auditime energjetike.
- ✓ Lëshojnë raport verifikimi.
- ✓ Certifikojnë ndërtesat.

Burimi: Informacione zyrtare, subjektet nën auditim  
Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>16</sup> [http://www.klsh.org.al/web/njoftimi\\_per\\_web\\_burimet\\_alternative\\_1974.pdf](http://www.klsh.org.al/web/njoftimi_per_web_burimet_alternative_1974.pdf)

- *Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*, me mbështetjen e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë, harton politikat kombëtare për eficiencën e energjisë, si dhe monitoron zbatimin e tyre. Në politikat kombëtare për përdorimin eficient të energjisë përcaktohen drejtimit për arritjen e objektivave kryesorë kombëtarë, mekanizmat, iniciativat, aftësitë institucionale dhe financiare, si dhe kuadri i duhur ligjor për shmangien e çdo barriere ekzistuese tregu për përmirësimin e eficiencës së energjisë në vend<sup>17</sup>. MIE propozon për miratim në Këshillin e Ministrave Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes, për llogaritjen e performancës së integruar të energjisë së ndërtesave<sup>18</sup>.

- Agjencia për Eficiencën e Energjisë harton Planin Kombëtar të Eficiencës së Energjisë, i cili duhet të rishikohet çdo tre vjet, si dhe monitoron zbatimin e tij. Nga skema e mësipërme, mund të vërehet se veprimtaria e AEE-së ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e aktiviteteve dhe proceseve, për të siguruar eficiencë në energji. Disa prej detyrave dhe përgjegjësi kryesore të AEE<sup>19</sup> janë:

- ✓ Koordinimi programet e eficiencës së energjisë;
- ✓ Krijimi/përditësimi i bazës së të dhënave të energjisë;
- ✓ Mbajtja/përditësimi i regjistrit të audituesve të energjisë, të kompanive të shërbimit të energjisë, kopje të çertifikatave të energjisë, të raporteve të auditimit, bilance të konsumit të energjisë të konsumatorëve të mëdhenj;
- ✓ Kryerja sistematike e një procesi verifikimi për të gjitha të dhënat e referuara në raportet e verifikimit për çertifikatat e performancës së energjisë së ndërtesave, të lëshuara nga audituesit e energjisë;
- ✓ Lidhja e marrëveshjeve vullnetare me konsumatorët e mëdhenj të energjisë;
- ✓ Mbikëqyrja dhe verifikimi i saktësisë së të dhënave të raporteve të audituesve energjetik;
- ✓ Vlerësimi teknik i projekteve në fushën e EE (ato të financuara nga Fondi EE);
- ✓ Propozimi te Fondi i EE për dhënien e mbështetjes financiare për projektet e vlefshme;
- ✓ Zhvillimi dhe koordinimi i programeve të trajnimit;
- ✓ Mbështetja dhe këshillimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik dhe veprimtarive të tjera edukative;
- ✓ Vendosja e masave disiplinore; etj.

- *Fondi për Eficiencën e Energjisë* sipas përkufizimit të Ligjit nr 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” është person juridik që ka për qëllim dhënien e mbështetjes financiare në rastet e kryerjes së investimeve për marrjen e masave për përmirësimin e eficientësisë së energjisë. Nga ky Fond mund të përfitojnë shoqëritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji, konsumatorët fundorë, shoqëritë e shërbimeve energjetike dhe siguruesit e masave të përmirësimit të eficiencës së energjisë. Fondi

---

<sup>17</sup> Ligj Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Neni 5, pika 2.

<sup>18</sup> Ligj Nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”, Neni 5, pika 8

<sup>19</sup> Ligj Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Neni 25, pika 3.

financohet me burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret për të mbështetur financiarisht programet<sup>20</sup> si mëposhtë:

- ✓ Investimet që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë në konsumatorët fundorë;
- ✓ Zhvillimin e projekteve pilot në fushën e EE;
- ✓ Auditimet e energjisë që do të kryhen në sektorin publik;
- ✓ Kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e eficiencës së energjisë;
- ✓ Fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitetet e edukimit në lidhje me eficiencën e energjisë; etj.

-Duke qenë se ky auditim është fokusuar kryesisht në sektorin e ndërtesave, në skemën e mësipërme është paraqitur harta e ndërveprimit që tregon lidhjet e ndërvarësisë midis aktorëve kryesorë, për të siguruar përdorimin eficient të energjisë në ndërtesa<sup>21</sup>. Referuar Ligjit nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”, pajisja e ndërtesave me Çertifikatën për Performancën e Energjisë është e detyrueshme dhe kjo çertifikatë duhet të jetë e vlefshme për 10 (dhjetë) vite. *Çertifikimi i performancës së energjisë së ndërtesave duhet të jetë i detyrueshëm për*<sup>22</sup>:

- a) të gjitha ndërtesat ose njësitë e ndërtesave, të cilat do të shiten ose do të jepen me qira;
- b) të gjitha ndërtesat, të cilat do të ndërtohen ose do t’i nënshtrohen rinovimit të rëndësishëm;
- c) të gjitha ndërtesat që janë në përdorim nga një autoritet publik ose nga institucionet që sigurojnë një shërbim ndaj publikut dhe që frekuentohen shpesh nga publiku, të cilat kanë një sipërfaqe të shfrytëzueshme mbi 500m<sup>2</sup> <sup>23</sup>.

Kjo çertifikatë lëshohet nga audituesit e energjisë, në bazë të të dhënave teknike të performancës së energjisë dhe raportit të verifikimit.

- *Audituesi energjetik* është një person fizik ose juridik, i licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, i cili kryen në mënyrë të pavarur auditime energjetik në ndërtesa. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport auditimi, një kopje e të cilit i dërgohet Agjencisë për Eficiencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm. Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen çdo 3 vjet për konsumatorët e mëdhenj të energjisë dhe çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera të vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.

---

<sup>20</sup> Ligj Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Neni 24, pika 1.

<sup>21</sup> Referuar ligjit “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”, ndërtesat klasifikohen në: tipat e ndryshëm të shtëpive/ndërtesave ku banon vetëm një familje; blloqet e apartamenteve; zyrat; ndërtesat e edukimit/arsimimit; spitalet; hotelet dhe restorantet; objektet sportive; ndërtesat ku zhvillohen aktivitete të tregtisë me shumicë ose pakicë që klasifikohen si ndërtesa shërbimi; tipa të tjerë ndërtesash që konsumojnë energji.

<sup>22</sup> Ligj Nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”, Neni 10, pika 1.

<sup>23</sup> Duke filluar nga data 9 korrik 2018, kërkesa për kufirin e mësipërm të sipërfaqes së shfrytëzueshme do të zvogëlohet në 250 m<sup>2</sup>


-Për të ndërmarrë masat e nevojshme (të cilat rekomandohen në raportet e prodhuara nga audituesit energjitikë) për të përmirësuar eficiencën e energjisë duhet të kryhen shërbime energjitike. *Shërbimet energjetike* ofrohen nga subjekte të licencuara për ofrimin e shërbimeve energjetike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ministria mban, përditëson dhe publikon në faqen e saj zyrtare një listë të ofruesve të shërbimeve energjetike.

### 1.4.1 Hyrje

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** ka si mision “hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë.”<sup>24</sup> *MIE është përgjegjëse për hartimin e politikave kombëtare për eficiencën e energjisë, si dhe për monitorimin e zbatimit të tyre.*<sup>25</sup>

Referuar Urdhërit të Kryeministrit nr. 72, dt. 27.04.2018, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë”, MIE ka në përbërjen e saj Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, e cila ka në varësi 5 (pesë) Drejtori, 3 (tre) prej të cilave të ngarkuara me përgjegjësi dhe detyra për eficiencën e energjisë. Në vijim paraqitet organigrama e pjesshme e MIE e fokusuar në drejtoritë që kanë përgjegjësi në eficiencën e energjisë.

**Skema 3:** Organigrama e pjesshme e MIE



Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>24</sup> <https://www.infrastruktura.gov.al/misioni-2/>

<sup>25</sup> Ligj Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Neni 5, pika 5.

**Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE)** është person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Kjo agjenci është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave në Dhjetor 2016<sup>26</sup>. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të saj parashikohen në VKM-në e krijimit të Agjencisë. “AEE-ja është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për eficiencën e energjisë”<sup>27</sup>. Referuar Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, deri në krijimin e AEE-së, MIE është përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara për Agjencinë<sup>28</sup>.

Referuar Urdhërit Nr. 56, dt. 20.04.2017, struktura e AEE është si më poshtë:

**Skema 4:** Organigrama e AEE



Burimi: AEE

Përpunoi: Grupi i auditimit

Sipas strukturës së miratuar, numri i punonjësve të AEE duhet të jetë 10 (dhjetë). Secili prej 3 (tre) sektorëve duhet të ketë në përbërjen e tij, 1 (një) përgjegjës sektori dhe 2 (dy) specialistë.

#### 1.4.2 Politikat e Institucionit/Agjencisë

MIE në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë garantimin e furnizimit me energji të vendit, shfrytëzimin e burimeve energjitike dhe minerale në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe dobishmërisë publike, nxitjen e zhvillimit industrial me standarde sa më miqësore për mjedisin. MIE është përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe realizimin e strategjive dhe politikave në fushën e Eficiencës së Energjisë në përputhje me zhvillimet kombëtare dhe rajonale bazuar në aktet ligjore e nënligjore dhe direktivat e BE-së. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë është struktura përgjegjëse në hartimin e politikave, programeve të zhvillimit të projekteve në fushën e Industrië dhe Energjisë. Kjo drejtori siguron, planifikon dhe negocion të gjitha objektivat madhore të Strategjisë Kombëtare të Energjisë. Objektiva ndaj të cilave MIE është e angazhuar të realizojë<sup>29</sup>:

<sup>26</sup> Vendim Nr. 852, Datë 7.12.2016 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë”.

<sup>27</sup> VKM Nr. 852, Datë 7.12.2016, Paragrafi I, pika 2.

<sup>28</sup> Ligj Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Neni 22, pika 1.

<sup>29</sup> Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030

- Vendosja e një objektivi indikativ (targetave - vlerave të synuara) për kursimin e energjisë kombëtare dhe përgatitja e një Plani Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) që duhet të përditësohet çdo tre vjet;
- Krijimin e institucionit të agjencisë për eficiencën e energjisë (“Agjencia për EE-në”) për të mbikëqyrur zbatimin e shumë dispozitave të ligjit dhe krijimin e një Fondi për Eficiencën e Energjisë (“Fondi EE”) për të mbështetur dhe financuar masat e eficiencës së energjisë;
- Krijimin e audituesve energjetike si eksperte tëpavarur dhe ndërmarrjeve të shërbimeve energjetike (ESCO) për shërbimet energjetik;
- Vendosja e skemave detyruese për konsumatorët e mëdhenj të energjisë (mbi 3 milionë kwh ekuivalentë) për të përmirësuar eficiencën e tyre të energjisë, duke kërkuar me ligj që ata të punësojnë një menaxher të energjisë dhe të kryejnë auditime të rregullta të energjisë për të adresuar kërkesat për EE-në
- Vendosja e kriterëve dhe standardeve për licencimin e audituesve të energjisë dhe ofruesit e shërbimeve energjetike (ESCO-t).

Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) është krijuar në bazë të detyrimit që lind nga Ligji nr 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”. AEE si institucion varësie i MIE, është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për eficiencën e energjisë. AEE përgatit, zbaton dhe monitoron politikat dhe programet për përdorimin eficient të energjisë në sektorët rezidencialë të shërbimeve. AEE ka si qëllim të bashkëpunojë me autoritetet qendrore dhe vendore, shoqëritë që operojnë në objektet industriale dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse për krijimin dhe përditësimin e bazës së nevojshme të të dhënave të energjisë, përfshirë llogaritjen e treguesve të eficiencës së energjisë, si dhe për zbatimin e masave për nxitjen e eficiencës së energjisë<sup>30</sup>. AEE harton rregullat të cilat përcaktojnë mënyrën se si audituesit e energjisë duhet të veprojnë në përgatitjen e certifikatës për performancën e energjisë, raportet e auditimit dhe ato të verifikimit.

### 1.4.3 Pesha në buxhet

Sikurse është trajtuar edhe më herët, sektori i energjisë është mbështetës për zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së popullsisë. Investimet e kryera në këtë fushë janë mjaft të rëndësishme për të siguruar zhvillimin e qendrueshëm të sektorit, përmbushur detyrat që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare, mbrojtur mjedisin, si dhe për të përmirësuar mirëqenien e vendit.

**Tabela 1:** Pesha që zë programi “Mbështetje për Energjinë” në buxhetin e MIE

Viti/Buxheti	2016	2017	2018	2019
Buxheti total MIE	3,128,075	41,535,632	47,681,180	45,434,704
Buxheti për programin “Mbështetje për Energjinë”	788,548	2,279,600	8,574,775	4,959,900
<b>ME/Buxhetit MIE</b>	<b>25%</b>	<b>5%</b>	<b>18%</b>	<b>10.92%</b>

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i auditimit

<sup>30</sup> Ligji 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 25

Nga të dhënat e analizuara nga grupi i auditimit, rezulton se buxheti i alokuar ndër vite nga ministria përgjegjëse<sup>31</sup> për të mbështetur sektorin e Energjisë, nuk shfaq një trend të qëndrueshëm. Megjithatë buxheti i alokuar për energjinë është rritur krahasuar me vitin 2016, pesha e tij (relative) ndaj buxhetit total të ministrisë është ulur.

**Tabela 2:** Pesha që zë programi “Mbështetje për Energjinë” në buxhetin e shtetit

000/lekë

Viti/Buxheti	2016	2017	2018	2019
Buxheti i Shtetit	264,141,978	283,299,687	306,174,422	308,078,194
Buxheti për programin “Mbështetje për Energjinë (ME)”	788,548	2,279,600	8,574,775	4,959,900
<b>ME/Buxhetit të Shtetit</b>	<b>0.3%</b>	<b>0.8%</b>	<b>2.8%</b>	<b>2%</b>

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i auditimit

Fondet e planifikuara për energjinë në vendin tonë për vitin 2019, zinin rreth 2% të buxhetit të shtetit. Për vetë rëndësinë që ka përmirësimi i eficiencës së energjisë për sektorin e energjisë dhe ekonominë në tërësi, si dhe për të evidentuar mbështetjen me buxhet të masave të parashikuara për t’u ndërmarrë, grupi i auditimit analizoi fondet e alokuara nga buxheti i shtetit dhe financimet e huaja për të mbështetur arritjen e objektivave strategjik në fushën e EE-së.

**Tabela 3 :** Investimet në sektorin publik për EE 2018–2030

<b>Aktiviteti EE</b>	<b>mil. Euro</b>
Zbatimi i masave të PKVEE deri 2020 (6.8% kursime)	140
Zbatimi i masave të PKVEE deri 2030 (15.5% kursime)	347
Fushata ndërgjegjësimi 2018–2030	45
<b>Totali</b>	<b>532</b>

Burimi: Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030

Përpunoi: Grupi i auditimit

Referuar Strategjisë Kombëtare të Energjisë, është parashikuar që deri në 2020 investimet në EE të tejkalojnë vlerën prej 140 milionë Euro. Këto fonde duhet të sigurohen kryesisht nga financime të huaja dhe buxheti i shtetit ku janë parashikuar të përdoren për zbatimin e masave të parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit të Eficiencës së Energjisë 2017-2020, për të realizuar fushata ndërgjegjësimi dhe projekte pilote<sup>32</sup>. Sikurse përcaktohet edhe në dokumentin strategjik, këto fonde përfaqësojnë gjithashtu edhe investimet e kërkuara/ të nevojshme për të siguruar arritjen e objektivave në këtë fushë.

Krahas parashikimeve, grupi i auditimit ka analizuar buxhetin e planifikuar për eficiencën e energjisë gjatë periudhës objekt auditimi 2016-2019, si pjesë përbërëse e programit të Energjisë (Mbështetje për Energjinë).

<sup>31</sup> Ish-Ministria e Industrisë dhe Energjisë deri në 2016, më tej Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

<sup>32</sup> Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030, fq. 53.

**Tabela 4:** Buxhetet e planifikuara për EE kundrejt atyre të planifikuara për sektorin e energjisë


000/lekë

Viti/Buxheti	2016	2017	2018	2019
Buxheti për programin “Mbeshtetje për Energjinë”	788,549	2,279,600	8,574,775	4,959,900
Buxheti për EE	313,604	561,400	502,751	726,207
<b>Buxheti për EE/ ME</b>	<b>40%</b>	<b>25%</b>	<b>6%</b>	<b>15%</b>

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i auditimit

Sikurse mund të vërehet edhe nga tabela e mësipërme buxheti i planifikuar ndër vite për EE ka pësuar rritje. Në 2019 buxheti për EE ka qenë afërsisht 2 (dy) herë më i lartë se në 2016. Nga analizimi dhe krahasimi i të dhënave të mësipërme rezulton se, trendi rritës i fondeve të akorduara për EE nuk ka të njëjtën normë me atë të sektorit të energjisë në tërësi, për të cilin në 2018 janë planifikuar rreth 10 (dhjetë) herë më shumë fonde se në 2016. Vërehet gjithashtu se, pesha që zënë fondet e akorduara për EE, kundrejt fondeve të akorduara për sektorin e energjisë në tërësi ka pësuar rënie ndër vite. Në 2018 vetëm 6% e fondeve të sektorit të energjisë i janë dedikuar eficiencës së energjisë. Në total përgjatë periudhës 2016-2019, investimet e planifikuara në buxhetin e shtetit për EE arrijnë në vlerën 2,103,962,000 lekë, vlerë kjo konsiderueshëm më e ulët se investimet e kërkuara/ të nevojshme (më tepër se 140 milion euro) në këtë fushë deri në 2020, parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Energjisë.

**Grafiku 1:** Buxheti për EE kundrejt buxhetit për Energjinë për periudhën 2016-2019

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i auditimit

Sa më lart, me interes shfaqet edhe analizimi i fondeve faktike të alokuara/investuara për eficiencën e energjisë, pra niveli i realizimit ndër vite i buxheteve të planifikuara. Më poshtë, grupi i auditimit ka paraqitur në formë tabelare buxhetet e planifikuara për EE për periudhën 2016-2019, si dhe realizimin e tyre, të klasifikuara në financime të huaja (F.H) dhe buxheti i shtetit (B.SH).

**Tabela 5:** Fondet e realizuara kundrejt atyre të planifikuara për eficiencën e energjisë


000/lekë

Viti	2016		2017		2018		2019	
	B.SH	F.H	B.SH	F.H	B.SH	F.H	B.SH	F.H
Burimi								
Planifikimi	<b>313,604</b>		<b>561,400</b>		<b>502,751</b>		<b>726,207</b>	
	56,604	257,000	154,400	407,000	252,751	250,000	134,500	591,707
Fakti	<b>269,704</b>		<b>109,104</b>		<b>236,812</b>		<b>N/A<sup>33</sup></b>	
	53,889	215,815	5,252	103,852	195,409	41,403	77,894	N/A
<b>Realizimi</b>	<b>95%</b>	<b>84%</b>	<b>3%</b>	<b>26%</b>	<b>76%</b>	<b>17%</b>	<b>58%</b>	<b>N/A</b>

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, rezulton se përgjatë periudhës 2016-2019 investimet në fushën e EE në vendin tonë kryesisht janë mbështetur me fonde të huaja. *Niveli i realizimit të buxheteve, pra fondet realisht të investuara në EE, janë ndjeshëm më të ulëta se planifikimi faktik.*

**Grafiku 2:** Buxheti faktik dhe realizimi i buxhetit për periudhën 2016-2019<sup>34</sup>

Burimi: MIE

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në 2017, realizimi i buxhetit për fushën e EE ka qenë 3% për fondet e brendshme dhe 26% për financimet e huaja. Në vijim të auditimit, grupi i auditimit ka analizuar më në detaje projektet e realizuara në fushën e EE përgjatë periudhës në auditim.

#### 1.4.4 Risqet e aktiviteteve të subjekteve

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, pra MIE dhe AEE, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer

<sup>33</sup> Sektori i Financës në MIE nuk zotëron ende informacion për realizimin e financimit të huaj për vitin 2019.

<sup>34</sup> Vlera e paraqitur në grafik për buxhetin e realizuar në vitin 2019 nuk përfaqëson nivelin e realizimit për këtë vit, pasi MIE ende në Qershor 2020 nuk ka informacion mbi nivelin e realizimit të buxhetit për vitin 2019.

analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke analizuar dhe evidentuar risqet e aktivitetit të subjekteve të klasifikuara në fuqitë, dobësitë, shanset, kërcënimet si dhe në analizën PESTLE duke marrë në konsideratë risqet e gjashtë fushave të ndryshme në të cilat shtrihet kjo analizë e respektivisht në nivelin politik, ekonomik, social, teknologjik, ligjor e mjedisor. Analiza PESTLE është një mjet i rëndësishëm që ndihmon në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në funksionimin e një institucioni apo procesi të caktuar.<sup>35</sup> Gjatë përdorimit të kësaj analize është e rëndësishme që faktorët që ndikojnë në funksionimin e procesit për të cilën kjo analizë kryhet, jo vetëm të identifikohen por edhe të vlerësohen aty ku është e mundur. Kjo analizë rrisht ka karakter paraprak dhe në vazhdimësi të auditimit, nëse do të jetë e nevojshme, do të kryhet një rivlerësim dhe/ose përditësim i risqeve të identifikuara. Kjo analizë krahas risqeve që lidhen me politikat është fokusuar edhe në risqet ekonomike, sociale e mjedisore duke qenë se efienca e energjisë ndikon drejtpërsëdrejti në të tre këto fusha. Kujdes të veçantë i është kushtuar edhe sektorit të teknologjisë dhe impaktit që ai jep në përdorimin efiçent të energjisë.

**Tabela 6: Analiza SWOT**

<b>Fuqitë (S)</b>	<b>Dobësitë (W)</b>
Kuadri ligjor i miratuar nga Parlamenti mbi eficiencën e energjisë dhe performancën e energjisë së ndërtesave.	Mungesë e një Strategjie Kombëtare për rinovimin e ndërtesave ekzistuese.
Standardizimi i ndërtimeve dhe pajisjeve që konsumojnë energji bazuar në përvojën e vendeve të përparuara.	Mangësi ose moszbatim i kuadrit ligjor në fuqi për eficiencën e energjisë.
Ngritja dhe funksionimi i Agjencisë së Eficiencës së Energjisë si institucion përgjegjës.	Kosto të larta për zbatimin e kërkesave të eficiencës së energjisë.
Ndikimi pozitiv në ruajtjen e mjedisit në drejtim të reduktimit të ndotjes e ajrit. gazeve serë; etj.	Mungesa e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes të Eficiencës së Energjisë.
	Ndryshimet dhe lëvizjet e shpeshtë e stafit që merret me eficiencën e energjisë.
	Punë e pamjaftueshme e institucioneve shtetërore në drejtim të edukimit të publikut mbi eficiencën e energjisë.
	Mungesa e stimujve ekonomikë për zbatimin e masave që përmirësojnë eficiencën e energjisë.
	Monitorim i dobët i performancës së eficiencës së energjisë nga AEE dhe MIE.
	Moslicensimi i audituesve për kryerjen e auditimeve energjetike.
	Promovimi i dobët i projekteve të zbatuara për eficiencën e energjisë.
<b>Shanset (O)</b>	<b>Kërcënimet (T)</b>
Mundësi të mëdha për përmirësimin e eficiencës së energjisë në sektorin e ndërtesave.	Rritja e kostove të investimeve në fushën e eficiencës së energjisë për sektorin publik dhe privat.

<sup>35</sup> www.free-management-ebooks.com. 2013 ISBN 978-1-62620-998-5

Mirëadministrim dhe kursimi i energjisë si një kërkesë për zhvillimin ekonomik në shkallë globale.	Nivel i lartë të pajisjeve të instaluara që konsumojnë energji të cilat nuk janë eficiente në sektorin publik dhe privat.
Rritja e konkurrueshmërisë së operatorëve.	Numër i madh i subjekteve shtetërore që nuk zbatojnë kërkesat e eficiencës së energjisë.
Projektet e parashikuara për Eficiencën e Energjisë.	Reagim i dobët i administratës shtetërore/ bizneseve/publikut për zbatimin e masave për rritjen e performancës së EE.
Zhvillimi i teknologjisë mundëson dhe përshpejton rritjen e eficiencës së energjisë deri te konsumatorët fundorë.	Moszbatimi në kohë i projekteve të eficiencës së energjisë.
Krijimi i kushteve për zhvillimin, nxitjen e tregut të shërbimeve energjetike.	Informacion i kufizuar dhe jo i përditësuar lidhur me eficiencën e energjisë.
Përcaktimi i mekanizmave financiarë që lidhen me rritjen dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë.	Mos realizimi i auditimeve të eficiencës së energjisë.
Eficienca e energjisë si një kërkesë për ngritjen e mirëqenies së qytetareve.	Mungesa e njohurive për risqet e ndryshme të performancës së eficiencës së energjisë për sektorin publik & privat.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Tabela. 7: Analiza e Riskut (PESTLE) <sup>36</sup>

<b>P</b> Political	<b>E</b> Economic	<b>S</b> Social	<b>T</b> Technological	<b>L</b> Legal	<b>E</b> Environment
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e monitorimit periodik të Planit Kombëtar të Veprimit të Eficiencës së Energjisë. <b>D</b></li> <li>• Mungesë e një sistemi efektiv të penalteteve për mos përputhjen me normat dhe standardet kombëtare të eficiencës së energjisë. <b>D</b></li> <li>• Ndryshimet në qeverisje sjellin ndryshime të Organikës të institucioneve përgjegjëse për eficiencën e energjisë, të cilat jo gjithmonë pasojnë përgjegjësitë e strukturave / departamenteve të caktuara në rregulloret/udhëzimet e mëparshme. <b>D</b></li> <li>• Mungesë e një Strategjie Kombëtare për rinovimin e ndërtesave ekzistuese. <b>D</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mos përdorimi i instrumentave financiare si dhe promovimit të tyre të qytetarët dekurajon iniciativat për marrjen e masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë. <b>D</b></li> <li>• Mos krijimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë sjell ulje të investimeve nga të gjithë palët e interesit (transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji, konsumatorët fundorë, shoqëritë e shërbimeve energjetike dhe siguruesit e masave) që mund të përfitojnë nga ky fond dhe që mund të marrin masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë. <b>D</b></li> <li>• Buxhet i limituar për AEE. <b>D</b></li> </ul>	<p>Mungesa e investimeve në Eficiencën e energjisë nuk krijojnë rritje të punësimit. <b>A</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Efekte shëndetësore negative që vijnë nga të jetuarit në ndërtesa me performancë të ulët të energjisë. <b>D</b></li> <li>• Burime dhe kapacitete të njerëzore të kufizuara në zhvillimin e trajnimeve, fushatave sensibilizuese dhe monitorimit të projekteve në fushën e EE. <b>D</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimi i teknologjisë mundëson dhe përshpejton rritjen e eficiencës së energjisë në ndërtesa nëpërmjet një norme më të lartë të rinovimit të ndërtesave dhe me një kosto më të ulët. <b>A</b></li> <li>• Mungesa e matësve inteligjentë në Shqipëri nuk ndikon pozitivisht në konsumin me eficiencë të energjisë nga konsumatori fundor. <b>D</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e Rregullores së Brendshme të Funksionimit të MIE. <b>D</b></li> <li>• Mungesa e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes (e cila duhet të jetë e miratuar me VKM) sjell mungesë të ekspertizës në performancën e energjisë së ndërtesave dhe në auditimet energjitike. <b>D</b></li> <li>• Mungesë e Audituesve Energjitikë të licensuar për kryerjen e auditimeve energjitike. <b>D</b></li> <li>• Mungesa e Çertifikatave të Performancës së Energjisë së Ndërtesave. <b>D</b></li> </ul>	<p>Masat e marra për përmirësimin e eficiencës së energjisë ndikojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit duke qenë se ulja e kërkesës për energji do të ulë gjithashtu emetimet nga djegia e lëndëve fosile që shërbejnë për prodhimin e energjisë. <b>A</b></p> <p>Reduktimi i gazeve serë është një tjetër aspekt pozitiv mjedisor që lidhet me përmirësimin e eficiencës së energjisë. <b>A</b></p>

<sup>36</sup> Për të treguar ndikimin që çdo faktor ka mbi Eficiencën e Energjisë, përbri tyre është vendosur shkronja **A**-Avantazh ose **D**-Disavantazh

#### 1.4.5 Rëndësia e produkteve të subjektit

*“Përveç zvogëlimit të emetimeve të gazrave serë, eficienca e energjisë mund të sjellë përfitime të shumta, duke përfshirë: ndikime pozitive në shëndet, zbutjen e varfërisë dhe rritjen e të ardhurave të disponueshme, rritje të ekonomisë së shkallës në qytete, energji të sigurt dhe të përbalueshme për të vënë në punë automjetet dhe pajisjet, si dhe përmirëson transportin”<sup>37</sup>. Referuar Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, deri në vitin 2030 synohet dyfishi i nivelit global të përmirësimit të eficiencës së energjisë<sup>38</sup>. Vendi ynë është ende në hapat e para të zhvillimit të përmirësimeve për përdorimin eficient të energjisë dhe krijimit të kushteve të nevojshme për të bërë të mundur përparimin në këtë drejtim. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Agjencia e Eficiencës së Energjisë janë dy institucionet me përgjegjësi dhe detyra të ngarkuara, me qëllim realizimin e produkteve në fushën e EE, në drejtim të përmbushjes së objektivave kombëtare të përcaktuara në dokumentet strategjike të vendit.*

Referuar kuadrit ligjor, SKE-së dhe PKVEE-së, produktet dhe shërbimet kryesore që institucionet përgjegjëse duhet të prodhojnë janë si më poshtë:

- Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (i përditësuar çdo 3 vjet);
- Raporte vjetore monitorimi mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë;
- Fondi i Eficiencës së Energjisë;
- Baza e të dhënave kombëtare të energjisë;
- Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes së performancës së energjisë së ndërtesave;
- Programi kompjuterik i miratuar (Software-i PEN);
- Kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementeve të ndërtesave, të përcaktuara dhe të miratuara;
- Ndërtesa të rinovuara;
- Auditime energjitike të kryera, dhe raportet e tyre të auditimit të hartuara;
- Çertifikata për performancën e energjisë së ndërtesave;
- Regjistri Kombëtar i Çertifikatave të Performancës së Energjisë;
- Plani kombëtar për ndërtesat me performancë “afër zero energji”;
- Lista e publikuar (e përditësuar) e ofruesve të shërbimeve energjetike;
- Lista e publikuar (e përditësuar) e audituesve të energjisë;
- Trajnime për përfaqësues të insitucioneve qendrore dhe vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë;
- Fushata edukimi dhe ndërgjegjësimi mbi nevojën dhe përfitimet nga reduktimi i konsumit joeficient dhe joekonomik i energjisë;
- Marrëveshje vullnetare të lidhura midis Agjencisë për Eficiencën e Energjisë dhe Konsumatorëve të mëdhenj të energjisë;
- Skema mbështetëse financiare për përmirësimin e performancës së energjisë; etj.

#### 1.4.6 Feedback-u i subjektit

Sa i përket bashkëpunimit të subjekteve nën auditim me grupin e auditimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për fazën studimore ka rezultuar si më poshtë:

---

<sup>37</sup><https://www.undp.org/content/undp/en/home/ourwork/climate-and-disaster-resilience/sustainable-energy/energy-efficiency/>

<sup>38</sup> OZHQ, Objektivi 7: Energji e pastër dhe e përbalueshme, Nën-objektivi 7.3.

- ✓ Nga subjekti MIE ka patur bashkëpunim korrekt me Drejtorin e Përgjithshëm të Politikave të Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, z. GJ. S. Ndërkohë, grupi i auditimit shpreh rezerva në bashkëpunimin me Sekretaren e Përgjithshme të MIE, znj. V.H. e cila nuk i është përgjigjur shkresës me nr. Prot. 26/2 datë 26.02.2020 si dhe emailit të dërguar nga grupi i auditimit më datë 05.03.2020 ora 14:54.

Ministri i MIE të analizojë dhe të fillojë procedurën për masë disiplinore ndaj Sekretarit të Përgjithshëm të MIE znj. V. H., për mosbashkëpunim dhe mosdhënie informacioni grupit të auditimit të KLSH-së në lidhje me listën e plotë të projekteve të përfunduara në fushën e Eficiencës së Energjisë në periudhën 2016-2019, kërkuar me shkresën me nr. Prot. 26/2 datë 26.02.2020 si dhe me emailin e dërguar nga grupi i auditimit më datë 05.03.2020 ora 14:54, në zbatim të nenit 26, pika 1 dhe pika 2 të Ligjit 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- ✓ Subjekti AEE është treguar bashkëpunues dhe i është përgjigjur në kohë dhe me përgjegjësi grupit të auditimit.

## **2. QASJA DHE DETAJET E AUDITIMIT**

### **2.1 Objektivi dhe problemi i performancës**

Auditimi me temë “Eficienca e Energjisë” ka synuar të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv nëse burimet publike janë manaxhuar me përgjegjësi duke informuar publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë mbi efektivitetin e veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për promovimin dhe përdorimin eficient të energjisë dhe arritjen e rezultateve të synuara. Në këtë mënyrë kemi mundur të konkludojmë se deri në çfarë mase ka qenë efektive veprimtaria e institucioneve subjekt auditimi.


#### **2.1.1 Fokusimi dhe përkufizimi i problemit**

Në këtë auditim jemi përqendruar në analizimin e efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi dhe politikave që synojnë përdorimin eficient të energjisë. Periudha kryesore objekt auditimi është 2016-2019. Fokusimi i auditimit krahas shqyrtimit në tërësi të zbatimit të politikave qeveritare lidhur me eficiencën e energjisë ka qenë veçanërisht në sektorin e ndërtesave duke qenë se mundësitë për kursimin e energjisë në ndërtesa janë tepër të larta dhe ndikimi në shëndetin e popullatës lidhet ngushtë me marrjen e masave të përmirësimit të performancës së energjisë në ndërtesa. Performanca e energjisë në ndërtesa është një proces i tërë që kalon dhe përfshin hallka të ndryshme që duhet të jenë funksionale duke filluar me:

- Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes;
- Ndërtesat me performancë “afër zero energji”;
- “Çertifikatën për performancën e energjisë” së ndërtesave;
- Audituesit energjetikë për certifikimin e performancës së energjisë;
- Shërbimet energjitike, etj.

Të gjitha elementët e mësipërm të bashku me promovimin, ndërgjegjësimin dhe edukimin e përdoruesve fundorë të energjisë nga ana e institucioneve përgjegjëse si dhe përfitimet e pritshme të projekteve në eficiencën e energjisë kompletojnë fokusimin tonë në këtë auditim.

## Skema 5: Modeli Input - Output



Përpunoi: Grupi i auditimit

### 2.1.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Eficienca e Energjisë” shtrihet në periudhën **2016–2019** dhe synon të analizojë efektivitetin e institucioneve subjekt auditimi të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë nxitjen dhe përdorimin eficient të energjisë. Ky auditim ka për qëllim të ofrojë një tablo të qartë mbi integritetin, besueshmërinë, transparencën dhe efektivitetin e projekteve të eficiencës së energjisë të mbështetura nga qeveria shqiptare për të parë nëse këto projekte kanë sjellë përfitimet e pritshme për përfituesit dhe përdoruesit finalë.

## 2.2 Përkufizimet dhe terminologjia

- “*Eficienca e energjisë*” është rezultati, në përqindje, i raportit ndërmjet sasisë së energjisë në dalje me sasinë e energjisë në hyrje.
- “*Energji*” është çdo formë energjie e disponueshme në treg, përfshirë energjinë elektrike, gazin natyror (përfshirë gazin natyror të lëngshëm), gazin e lëngshëm të naftës, çdo lëndë djegëse për ngrohje dhe ftohje (përfshirë ngrohjen dhe ftohjen e përqendruar e rajonale), qymyrin dhe linjtin, torfën, karburantet për transport (duke përjashtuar karburantet e përdorura në aviacion dhe transportin detar), biomasën, energjinë diellore, energjinë e erës, energjinë gjeotermale dhe energjinë nga mbetjet urbane.
- “*Intensiteti i energjisë*” është raporti i konsumit vjetor të energjisë nga konsumatorët fundorë me prodhimin e brendshëm bruto (GDP) të vendit.
- “*Kursim i energjisë*” është sasia e energjisë së kursyer, e përcaktuar nëpërmjet matjes dhe/ose përlllogaritjes së konsumit, përpara dhe pas implementimit të një mase përmirësimi efience, kur nuk ndryshojnë kushtet e jashtme që ndikojnë në konsumin e energjisë.
- “*Mekanizmat e Eficiencës së Energjisë*” janë mekanizmat që ndërmerren nga institucionet ose agjencitë shtetërore përgjegjëse për energjinë për të krijuar një kuadër ose skema mbështetëse për pjesëmarrësit e tregut për ofrimin dhe blerjen e shërbimeve të energjisë, si dhe masa të tjera të përmirësimit të Eficencës së Energjisë.
- “*Performanca energjetike e një ndërtese*” është sasia e përlllogaritur ose e matur e energjisë, e nevojshme për të plotësuar kërkesën për energji, lidhur me një përdorim normal të ndërtesës, që përfshin, ndërmjet të tjerash, energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë dhe ndriçim.
- “*Agjencia për Eficiencën e Energjisë*” është institucioni shtetëror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë, që funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 124/2015, “Për Eficiencën e energjisë”.
- “*Auditues energjetik*” është një person fizik ose juridik, i licencuar për të kryer auditime energjetike, siç përcaktohet në ligjin nr. 124/2015, “Për Eficiencën e energjisë”.
- “*Auditim energjetik*” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/ose instalimi industrial, në pronësi ose përgjegjësi administrimi të një personi juridik, publik ose privat, me qëllim identifikimin dhe përlllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e

rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të eficiencës së energjisë.

- “*Çertifikatë për performancën e energjisë*” është një dokument i lëshuar nga audituesi energjetik, ku përcaktohet performanca e energjisë së një ndërtese ose të njësisë së një ndërtese, e përcaktuar dhe e lëshuar sipas kërkesave të këtij ligji.
- “*Çertifikimi i performancës së energjisë së ndërtesës*” është procesi, i cili mundëson lëshimin e certifikatës së performancës së energjisë për një ndërtesë ekzistuese ose për një njësi të një ndërtese ekzistuese apo që do të ristrukturohet apo do të rinovohet.
- “*Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes*” është mënyra për llogaritjen e performancës së integruar të energjisë së një ndërtese ose njësie të një ndërtese.
- “*Kodi i praktikës për audituesit e energjisë*” është tërësia e rregullave të hartuara nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë, që përcaktojnë mënyrën se si audituesit e energjisë duhet të veprojnë kur të përgatitin certifikatat për performancën e energjisë, raportet e auditimit dhe ato të verifikimit.
- “*Ndërtesë me performancë afër zero energji*” janë ndërtesat që kanë një performancë shumë të lartë të energjisë, siç përcaktohet në Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes.
- “*Performanca e energjisë së një ndërtese*” është sasia e llogaritur ose e matur e energjisë, e nevojshme për të plotësuar kërkesat për energji, e shoqëruar me një përdorim tipik të ndërtesës, e cila përfshin, ndër të tjera, energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë dhe ndriçim.
- “*Financimi nga palë të treta*” është një kontribut financiar që i sigurohet përfituesit nga një palë e tretë, e ndryshme nga furnizuesi i energjisë, e cila siguron kapitalin financiar për zbatimin e plotë ose të pjesshëm të masave për përmirësimin e eficiencës së energjisë, duke i ngarkuar përfituesit detyrimin e një pagese që llogaritet mbi bazën e përfitimit që arrihet si rezultat i zbatimit të masave të përmirësimit të eficiencës së energjisë.
- “*Konsumator fundor*” është një person fizik ose juridik që blen energji vetëm për nevojat e tij.
- “*Konsumator i madh i energjisë*” është një konsumator fundor, i cili, në bazë të të dhënave të një procesi auditimi, rezulton se ka konsum vjetor të energjisë më të madh se ekuivalenti i 3 milionë kWh në vit.
- “*Kontraktimi i performancës energjetike*” është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet përfituesit dhe siguruesit të masave të përmirësimit të eficiencës së energjisë, ku investimet në masa (puna, furnizimi apo shërbimi) paguhet nga përfituesi në raport me nivelin e përmirësimit të eficiencës së energjisë, sikurse përcaktohet në marrëveshje.
- “*Ndërtesë*” është një konstrukcion me mure ose materiale të ngjashme, i mbuluar, në të cilin energjia përdoret për të plotësuar kërkesat për një ambient të brendshëm të përshtatshëm.
- “*Ndërtesë publike*” është një ndërtesë në pronësi të shtetit ose në përgjegjësi administrimi nga një person juridik publik.
- “*Shërbime energjetike*” është shërbimi dhe/ose produkti që përfitohet nga kombinimi i energjisë me teknologjinë e përdorur për përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe/ose masat, të cilat përfshijnë operimet, mirëmbajtjen dhe kontrollin e

nevojshëm për të siguruar eficientë e energjisë, sipas një kontrate, që vërtetohet se sjell përmirësime të verifikueshme dhe të matshme, ose të përlllogaritura të eficientës së energjisë dhe/ose kursime të energjisë primare.

- “*Shoqëri e shërbimeve energjetike*” është një person juridik që ofron shërbime energjetike dhe/ose masa të tjera të përmirësimit të eficientës së energjisë.
- “*Program kompjuterik i miratuar*” është një program kompjuterik, pronë e Agjencisë për Eficientë e Energjisë, i miratuar nga ministria përgjegjëse për energjinë dhe ministria përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, i ndërtuar mbi konceptet dhe bazën e të dhënave nga Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes, i cili shërben për të llogaritur performancën e energjisë së ndërtesave, në njësitë e ndërtesave dhe për përgatitjen e çertifikatave për performancën e energjisë.
- “*Çertifikatë e audituesit energjetik*”, çertifikata e lëshuar nga Agjencia për Eficientë e Energjisëm (AEE), që vërteton kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri;
- “*Diplomë*”, dokumenti zyrtar, i lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, që dëshmon përfundimin me sukses të një programi studimi;
- “*Regjistër*”, Regjistri i Audituesve Energjetikë të Çertifikuar, që mbahet dhe përditësohet nga AEE-ja.

## **2.3 Burime të Kriteve**

### **2.3.1 Kriteret politike**

- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013 -2020;
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030
- Plani i Dytë dhe i Tretë Kombëtar i Veprimit për Eficientë e Energjisë për Shqipërinë, 2016-2020.

### **2.3.2 Kriteret e monitorimit dhe raportimit**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 124/2015 “Për Eficientë e Energjisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”;
- VKM nr. 480, Datë 31.7.2018 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë”;
- VKM nr. 709, dt. 1/12/2017 “Për miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficientë e Energjisë”;
- VKM nr. 852, datë 7.12.2016 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Agjencisë për Eficientë e Energjisë”;
- VKM nr. 342, datë 22/5/2019 “Për Miratimin e Kategorive, të Kushteve dhe Kërkesave të Kualifikimit për Menaxherin e Energjisë”;
- VKM nr. 407, Datë 19.6.2019 “Për Miratimin e Procedurës, të Kategorive, Kushteve, Kërkesave të Kualifikimit dhe të Eksperiencës Profesionale për Personin, të Cilit i Lëshohet Çertifikata e Audituesit Energjetik”;

- Urdhër i Kryeministrit nr. 72, dt. 27/04/2018, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”;
- Urdhër i Kryeministrit nr. 160, dt. 05/10/2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”;
- Urdhër i Kryeministrit nr. 311, Dt. 10/10/2014 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”;
- Urdhër i Kryeministrit nr.97, datë 29.06.2015 Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.35, date 12.03.2015 te Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”;
- Urdhër i Kryeministrit nr. 419, datë 27.04.2018 “Per Kryerjen e Shërbimeve për Funkcionimet e Lidhura me Menaxhimin Financiar dhe Shërbimeve Mbështetëse”.
- Ligji nr. 10440, datë 7.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”;
- Ligji nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.


### **2.3.3 Kriteret teknike**

- First Annual Report under the Energy Efficiency Directive (AEE)
- Second Annual Report under the Energy Efficiency Directive (AEE)
- Artikuj nga media e shkruar dhe elektronike;
- Progres - Raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë 2019.

### **2.3.4 Kriteret e tjera**

- Directive (Eu) 2018/2002 of The European Parliament and of the Council of 11 December 2018 Amending Directive 2012/27/Eu On Energy Efficiency;
- Directive 2012/27/Eu Of The European Parliament And Of The Council Of 25 October 2012;
- European Energy Efficiency Fund (EEEF);
- EUROSAI WGEA Cooperative Audit “Energy Efficiency” of Public Sector Buildings;
- Audit Planning Memorandum Cost-effectiveness of EU funded energy efficiency investments in buildings;
- Assessing the Employment and Social Impact of Energy Efficiency, 2015;
- Interview - Energy efficiency benefits us all;
- Energy Performance Certificates Across the EU.
- Cost-effectiveness of Cohesion Policy Investments in Energy Efficiency, ECA, 2012.

## 2.4 PIRAMIDA E PYETJEVE AUDITUESE



## **2.5 Qasja/metodologjia e auditimit**

Grupi i auditimit vendosi mbi qasjen e përshtatshme për zhvillimin e këtij auditimi bazuar në të dhënat e grumbulluara gjatë fazës studimore, komunikimet me institucionet e përfshira në auditim. Tri kanë qenë qasjet audituese që janë përdorur:

1. Duke qenë se në këtë auditim është nevojitur informacion i përgjithshëm në lidhje me projektet e realizuara në fushën e eficiencës së energjisë për të parë nëse janë arritur përfitimet e pritshme nga këto kontrata nëpërmjet ndërhyrjeve dhe rikonstruksioneve në ndërtesat publike të përzgjedhura, qasja sasiore është një mënyrë mjaft e vlefshme për të arritur në konkluzione me besueshmëri të lartë. Kjo qasje përfshin përpilimin e anketave dhe pyetësorëve, shqyrtimin e rezultateve dhe hartimin e statistikave.

2. Qasja cilësore duke qenë më tepër qasje problemore dhe ku problemi nuk mund të kuantifikohet, është përdorur për atë pjesë të materialeve ku treguesit janë të pamatshëm si për shembull efektet sociale apo mjedisore nga zbatimi i projekteve për përmirësimin e masave për përdorimin eficient të energjisë.

3. Përveç dy qasjeve të mësipërme, për shkak të kompleksitetit të auditimit, është përdorur dhe qasja pragmatike. Kombinimi i qasjes sasiore me atë cilësore përdoret për të ndihmuar në dhënien e zgjidhjes ndaj një problemi të caktuar.

### **2.5.1 Metodatat/teknikat audituese**

Metodat e përdorura në metodologjinë e përzgjedhur janë si vijon:

- Rishikimi, analiza dhe vlerësimi i raporteve dhe të dhënave të mbledhura gjatë fazës studimore të auditimit;
- Intervista dhe pyetje të hapura me stafin e MIE, AEE, si dhe me palët e interesit; përpunim dhe analizim cilësor e sasior, i përgjigjeve të tyre;
- Mbledhje të dhënash nga burime sekondare dhe analizë e tyre;
- Marrje të dhënash dhe studim i tyre nga botime dhe publikime të ndryshme për eficiencën e energjisë.
- Analizë sasiore dhe cilësore të të dhënave të mbledhura gjatë fazës së terrenit.
- Konsulta me ekspertë të fushës, jashtë subjekteve të auditimit.
- Studim arkivor;
- Vëzhgim në terren i gjendjes dhe situatës për të parë nga afër problematikat që shtrohen në këtë auditim;
- Konsultim i literaturës, standardeve dhe praktikave të mira lidhur me eficiencën e energjisë por dhe të auditimeve të ngjashme të kryera nga SAI të tjera.

## **2.6 Rezultatet e parashikuara**

Auditimi i performancës me temë “Eficienca e Energjisë” synon të ketë një impakt të thellë jo vetëm financiar por edhe social duke qenë se është publiku që preket direkt dhe indirekt nga ky cilësia e ndërtesave në të cilat ata jetojnë e punojnë. Ky auditim, krahas përkrahimit dhe analizimit të kornizës ligjore e rregullatore ka për qëllim

dhënien e rekomandimeve për organet vendimmarrëse me qëllim përmirësimin e të gjithë faktorëve ndikues që pengojnë efektivitetin e funksionit të politikave dhe nismave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse. Pasqyrimi në media do t'i bëjë edhe më shumë jehonë këtij auditimi duke ndërgjegjësuar dhe vendosur para përgjegjësive institucionet përkatëse për të vepruar konform ligjit në përfitim të jetës së qytetarëve.

### **2.6.1 Impakti për Kuvendin dhe Qeverinë**

Rezultatet e këtij auditimi do të kenë rëndësi për legjislativin dhe ekzekutivin për arsye se këto institucione do të informohen në mënyrë të detajuar mbi përdorimin eficient të energjisë dhe veçanërisht të rezultateve të arritura nga institucionet përgjegjëse, duke synuar kështu ndërhyrjen e tyre, aty ky paraqitet e nevojshme, me qëllim përmirësimin e këtyre të fundit.

### **2.6.2 Impakti për publikun dhe palët e interesit**

Nga ky auditim, publiku dhe palët e interesit do të informohen lidhur me strukturat përgjegjëse për politikëbërjen dhe manaxhimin e projekteve të fushën e eficiencës së energjisë si dhe për efektet ekonomike dhe sociale që ato sjellin.

### **2.6.3 Forma e publikimit**

Në përfundim të auditimit është përgatitur Projekt-Raporti i Auditimit, i cili do t'i dërgohet subjekteve të përfshira në këtë auditim:

- 1) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- 2) Agjencisë së Eficiencës së Energjisë.

Pas marrjes së opinionëve dhe vlerësimit të tyre do të përgatitet Raporti Final i Auditimit dhe Vendimi përkatës, të cilët, pas aprovimit të Kryetarit, do t'u përcillen përsëri subjekteve nën auditim.

Më pas Raporti Final do të publikohet në faqen e Web-it të KLSH-së, në faqen Facebook të Departamentit të Performancës në KLSH, shtypin e përditshëm apo dhe në workshop-e të ndryshme dhe analiza vjetore të institucionit.

### **3. SHITJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE**

#### **A KA QENË EFEKTIVE VEPRIMTARIA E INSITUCIONEVE PËRGJEGJËSE NË FUSHËN E EE PËR PERIUDHËN 2016-2019?**

##### **Mesazhi i auditimit**

Masat e marra nga MIE dhe AEE lidhur me eficiencën e energjisë në vendin tonë nuk kanë qenë efektive. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duke mos miratuar një sërë aktesh nënligjore ka dështuar të plotësojë Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” dhe Ligjin nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa”. Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes nuk është miratuar me VKM. MIE nuk ka hartuar Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave Publike dhe Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji" si pjesë e PKVEE 2017-2020.

AEE nuk ka monitoruar PKVEE 2017-2020 dhe Ministri i MIE nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë. Si rezultat i mungesës së MKLL dhe audituesve energjitikë të çertifikuar nga AEE, deri më sot nuk është kryer asnjë auditim energjitik.

Mosfunksionimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë ka cënuar financimin e programit në fushën e eficiencës së energjisë, zhvillimin e projekteve pilot për të studiuar teknologji të reja, kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e EE, ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese si dhe zhvillimin e mekanizmave financiarë dhe fiskalë për nxitjen e investimeve. Projektet e eficiencës së energjisë të audituara në këtë auditim nuk kanë arritur objektivat e tyre kryesore. Pavarësisht situatës aktuale, gjatë kohës që ky auditim ishte duke u kryer (janar-qershor 2020), AEE ka hartuar dhe dërguar për miratim në MIE një sërë aktesh nënligjore. Miratimi i këtyre akteve, së bashku me zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë auditim subjekteve të audituara, do të sillte përmirësim në zbatimin e masave të eficiencës së energjisë.

#### **3.1 A kanë qenë efektive politikat në lidhje me eficiencën e energjisë?**

##### **3.1.1 A janë të përshtatshme dhe mjaftueshme politikat për promovimin dhe përdorimin eficient të energjisë?**

Për të promovuar përdorimin eficient të energjisë në vendin tonë janë miratuar Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030, Planin Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2017-2020, Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” i ndryshuar, Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” si dhe disa akte të tjera nënligjore. Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030 ka si vizion të saj zhvillimin e burimeve kombëtare të energjisë që çon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, i aftë për të përmbushur kërkesën për energji dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, sigurimin, mbrojtjen e mjedisit dhe

veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale. SKE garanton përmbushjen e detyrimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë duke zbatuar planet e veprimit për eficiencën e energjisë deri në transpozimin e kërkesave të Direktivës Evropiane të Eficiencës së Energjisë (Directive 2012/27/BE). Gjithashtu, prioritetet afatshkurtra për të ardhmen përfshijnë zhvillimin e legjislacionit sekondar dhe rregulloreve për zbatimin e Ligjit nr. 116.2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa” dhe Ligjit nr. 116 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”.<sup>39</sup> SKE është ngritur mbi disa objektiva ku synohet që të arrihen rezultate në përmirësimin e EE në sektorët rezidencialë, shërbime, transport, bujqësi dhe industri:

- Reduktimin e importeve të energjisë dhe rritjen e prodhimit vendas të energjisë nëpërmjet plotësimit të kërkesës së ardhshme për energji në një mënyrë të qëndrueshme duke rritur ndërkohë mirëqenien sociale;
- Përmirësimin e EE-së në sektorët rezidencialë, shërbime, transport, bujqësi dhe industri;
- Përmirësimin e harmonizimit dhe integritimit të politikës dhe rregullimit të sektorit shqiptar të energjisë me *acquis*-të e komunitetit të energjisë dhe tregjet rajonale dhe të BE-së;
- Zhvillimin e një kuadri politikash për energjinë (duke përfshirë eficiencën energjetike për transportin e qëndrueshëm) në transport bazuar në Strategjinë e Sektorit të Transportit në Shqipëri, dhe futja e teknologjive të reja në të gjithë sektorët e tij.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për Eficiencën e Energjisë”, me propozimin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave vendosi “Për Miratimin e Planit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2017–2020”. Ky dokument synon të ofrojë një vështrim gjithëpërfshirës mbi statusin e zbatimit dhe planet e ardhshme të politikave për eficiencën e energjisë në Shqipëri, si dhe përputhshmërinë e tyre me angazhimet e vendit në kuadrin e Komunitetit të Energjisë. Prandaj, ai hedh dritë mbi strategjinë e Shqipërisë për të transpozuar si kërkesat e Direktivës për Eficiencën e Energjisë (DEE), ashtu edhe të Direktivës për Performancën Energjetike të Ndërtesave (DPEN), duke përfshirë masat për EE-në që ndikojnë në furnizimin me energji primare, transformimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë, si dhe në konsumin final të energjisë. Ky dokument është strukturuar sipas modelit për “Planin e Tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë”, të ofruar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në tetor 2015. Për shkak të mungesës së një PKVEE-je të II-të për Shqipërinë, ky dokument është në përputhje me PKVEE-në e III-të, por përfshin progresin që nga hartimi i PKVEE-së së I-rë.<sup>40</sup>

---

<sup>39</sup> Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030

<sup>40</sup> PKVEE 2017-2020, fq 5.

Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” ka si qëllim të hartojë rregullat dhe politikat kombëtare për nxitjen, promovimin dhe përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë, me synim kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit, si dhe heqjen e pengesave në tregun e energjisë, vendosjen e objektivave kombëtarë të eficiencës së energjisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së operatorëve. Politikat kombëtare për përdorimin eficient të energjisë përcaktojnë drejtimitet për arritjen e objektivave kryesorë kombëtarë, mekanizmat, incentivat, aftësitë institucionale dhe financiare, si dhe kuadri i duhur ligjor për shmangien e çdo barriere ekzistuese tregu për përmirësimin e eficiencës së energjisë në vend.<sup>41</sup>

Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” ka për qëllim krijimin e kuadrit ligjor për përmirësimin e performancës së energjisë së ndërtesave, duke marrë në konsideratë kushtet lokale dhe klimaterike të vendit, kushtet e komfortit të brendshëm të ndërtesave, si dhe kostot efektive. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e:

- kuadrit të përgjithshëm për Metodologjinë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së integruar të energjisë së ndërtesave dhe të njësive të ndërtesave;
- kërkesave minimale për performancën e energjisë së ndërtesave të reja dhe të njësive të ndërtesave të reja;
- kërkesave minimale për performancën e energjisë së ndërtesave ekzistuese, të njësive dhe të elementeve të ndërtesave ekzistuese që do t’i nënshtrohen një rinovimi të rëndësishëm;
- kërkesave minimale për performancën e energjisë së sistemeve teknike të ndërtesave, sa herë që ato instalohen, zëvendësohen ose rikonstruktohen në ndërtesat ekzistuese;
- planeve kombëtare për rritjen e numrit të ndërtesave që konsumojnë pothuajse zero energji dhe kërkesave për çertifikimin e performancës.
- kërkesave për çertifikimin e performancës së energjisë së ndërtesave dhe të njësive të ndërtesave;
- kërkesave për verifikim të rregullt të sistemeve teknike të ndërtesës, përgatitjen e raporteve të verifikimit ose marrjen e masave alternative;
- kërkesave për krijimin e një sistemi kontrolli të pavarur për çertifikatat e performancës së energjisë së ndërtesave, të njësive të ndërtesave dhe për raportet e verifikimeve të sistemeve teknike.<sup>42</sup>

Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030, Plan i Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2017-2020 dhe dy ligjet e sipërpërmendura shprehin qartë

---

<sup>41</sup> Ligji nr.124/2015 për “Eficiencën e Energjisë”, neni 1

<sup>42</sup> Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”, neni 2.

detyrimet dhe përgjegjësitë e MIE dhe AEE në plotësimin dhe zbatimin me korrektësi të të gjithë kuadrit ligjor për Eficiencën e Energjisë. Për periudhën në auditim 2016-2019, janë hartuar dhe miratuar një pjesë shumë e vogël e akteve nën ligjore nga këto dy institucione. Një pjesë e mirë e dokumentave dhe akteve nënligjore janë hartuar dhe dërguar për miratim gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2020. Është për t'u theksuar se, deri më sot në Shqipëri nuk është lëshuar asnjë certifikatë e performancës së energjisë së ndërtesave, siç parashikohet në nenin 10 të Ligjit nr. 116/2016 "Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave", kjo si rezultat i mungesës së Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes e cila duhet të miratohet me VKM, por edhe mungesës së audituesve energjitikë të certifikuar nga AEE, e cila që nga fillimi i funksionit të saj në vitin 2018, për shkak të mungesave në burime njerëzore dhe logjistike nuk ka kryer asnjë testim për certifikimin e Audituesve energjitik sikurse parashikohet në nenin 17 të Ligjit nr. 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë". Testimi i parë është kryer në datë 22.05.2020, po sërish ky proces nuk ka efekt veprues pasi ende nuk është miratuar Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes për llogaritjen e performancës së energjisë në ndërtesa, i përcaktuar në nenin 6 të Ligjit nr. 116/2016 "Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave". Për këtë arsye, audituesit energjitikë edhe pasi të marrin certifikatën nga AEE, nuk mund ta ushtrojnë dot profesionin e tyre për aq kohë sa MKLL nuk është e miratuar me VKM. Ky dokument (MKLL) garanton llogaritjen e nivelit të konsumit të energjisë në përputhje me kërkesat e performancës së energjisë së ndërtesave, njërive dhe elementeve të ndërtesave, me qëllim vlerësimin, plotësimin dhe lëshimin e certifikatave të performancës së energjisë vetëm nëse do të funksionojë së bashku me programin kompjuterik i cili duhet të jetë ndërtuar mbi konceptet kryesore të MKLL-së. Që të lëshohet një certifikatë performance energjie është e nevojshme që MKLL të miratohet me VKM dhe të jetë në sinkron së bashku me programin kompjuterik (software PEN), program i cili edhe pse ekziston prej 3 vitesh nuk mund të funksionojë për aq kohë sa mungon MKLL.

## **Gjetje**

- MIE nuk ka Rregullore të Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.
- AEE nuk ka Rregullore të Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të saj.
- "Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes" (MKLL) së performancës së energjisë së ndërtesave nuk është e miratuar me VKM.
- Për periudhën 2016-2019 MIE nuk ka miratuar "Programin kompjuterik" bazuar në konceptet kryesore të MKLL.
- "Procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modeli, përmbajtja, kushtet e regjistrimit të "certifikatës për performancën e energjisë të ndërtesave" nuk janë miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- AEE për periudhën 2016-2019 nuk ka hartuar procedurat dhe kushtet e certifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modelin,

përmbajtjen, kushtet e rregjistrimit të “çertifikatës për performancën e energjisë të ndërtesave.

- Kategoritë e ndërtesave që janë objekt përjashtimi i Ligjit nr.116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” neni 4 pika 6 nuk janë miratuar me VKM.
- Kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave nuk janë miratuar me VKM.
- AEE për periudhën 2016-2019 nuk ka hartuar kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave.
- MIE nuk ka hartuar Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave Publike.
- Për periudhën 2016-2019 MIE nuk ka miratuar Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji" si pjesë e PVKEE.
- Kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e çertifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së çertifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa nuk janë miratuar me VKM.
- AEE për periudhën 2016-2019 nuk ka hartuar “kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e çertifikatave që do të verifikohen, si dhe për procesin e mbikëqyrjes së çertifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa”.
- Për periudhën 2016-2019 Ministri i MIE nuk ka miratuar Rregulloren e hartuar nga AEE “Për formatin e auditimit energjistik dhe pagesën për audituesin energjistik”.
- Ministri i MIE nuk ka miratuar Udhëzimin mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit mbi informimin dhe trajnimin e palëve të interesit sipas përcaktimit të bërë në Ligjin 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 15 pika 2 dhe 3.
- AEE nuk disponon një bazë të dhënash kombëtare të përditësuar, lidhur me konsumin final të energjisë dhe arritjet në kursimin saj.
- AEE nuk ka hartuar dhe propozuar për miratim në MIE, Udhëzimin për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike.

## **Konkluzione**

- Rregullorja më e fundit e miratuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë është ajo me Urdhërin nr. 311 datë 10.10.2014 “Për miratimin e Rregullore së Brendshme të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”. Kjo rregullore nuk përkon me strukturën e re të krijuar pas bashkimit të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe asaj të Infrastrukturës dhe Transportit. Mungesa e një Rregulloreje të brendshme të miratuar dhe të konsoliduar për MIE dhe AEE bën të pamundur identifikimin e qëllimeve, objektivave, detyrave dhe përgjegjësi kryesore institucionale. Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 102 pika 4 dhe Ligjit nr. 90/2012 Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 pika 2, rregullorja e

brendshme e funksionimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duhet të miratohet nga Ministri i MIE.

- Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes si një dokument mjaft i rëndësishëm për llogaritjen e performancës së integruar të energjisë në ndërtesa me qëllim vlerësimin dhe plotësimin e çertifikatave të performancës së energjisë, duhet të përdoret për vlerësimin e niveleve të kostos optimale, masave të eficiencës së energjisë dhe energjisë primare të nevojshme gjatë ciklit ekonomik afatgjatë të konsumit të energjisë.<sup>43</sup> Konceptet bazë të të dhënave nga MKLL ndihmojnë në ndërtimin dhe funksionimin e programit kompjuterik në lëshimin e çertifikatës së performancës së energjisë. Mungesa e MKLL dhe një programi kompjuterik të miratuar sjell dështimin e procesit të auditimit energjitik. Referuar Ligjit nr. 116/2016 për “Performancën e Energjisë së Ndërtesave”, neni 16 pika 2, MKLL duhej të ishte miratuar deri më datën 26.11.2017. Ministri i MIE nuk ka dorëzuar në Këshillin e Ministrave një draft të saj.
- Miratimi i “Procedurave dhe kushteve të çertifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modeli, përmbajtja, kushtet e regjistrimit të “çertifikatës për performancën e energjisë të ndërtesave” ndihmon në llogaritjen vjetore të performancës së integruar të energjisë së ndërtesës, treguesin numerik të konsumit të energjisë primare të ndërtesës dhe një tërësi informacionesh të cilat duhet të jenë teknikisht të arritshme për ndërtesën që çertifikohet duke përfshirë një vlerësim për periudhën e vetëshlyerjes ose koston e përfitimeve ekonomike gjatë ciklit të jetëgjatësisë së ndërtesës.<sup>44</sup> Drafti me Procedurat dhe kushtet e çertifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modeli, përmbajtja, kushtet e regjistrimit të “çertifikatës për performancën e energjisë të ndërtesave” është hartuar dhe dorëzuar nga AEE në MIE më datë 18.05.2020 jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 16 pika 1. Krijimi i Regjistrimit Kombëtar të Çertifikatave të Performancës së Energjisë siguron aksesin e palëve të interesuara për të kontrolluar vlefshmërinë e çertifikatave të performancës së energjisë.<sup>45</sup>
- Në Ligjin nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” neni 4 pika 1,2,3,4 dhe 5 janë përcaktuar të gjitha kategoritë e ndërtesave që janë objekt përjashtimi i këtij ligji. Neni 4 pika 6 e këtij ligji thekson se ato kategori që nuk janë përmendur në nenin 4 pika 1,2,3,4 dhe 5 duhen përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. AEE dhe MIE referuar Ligjit nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” neni 16 pika 5 kanë përgjegjësinë për hartimin e këtij akti nënligjor. Mungesa e këtij Vendimi sjell mos përcaktimin e plotë e të saktë të të gjitha kategorive të ndërtesave që janë objekt përjashtimi i këtij ligji.

---

<sup>43</sup> Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”, neni 5.

<sup>44</sup> Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 11 pika 1.

<sup>45</sup> Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 13.

- Hartimi dhe miratimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë kanë për qëllim arritjen e niveleve të konsumit energjetik optimal të ndërtesave. Këto kërkesa marrin parasysh kushtet e përgjithshme të brendshme klimaterike, në mënyrë që të shmangin efekte negative të mundshme siç mund të jetë ventilimi i papërshtatshëm, kushtet lokale, funksionet e caktuara dhe mosha e ndërtesës. Mungesa e miratimit të kërkesave minimale të performancës së energjisë ndikon negativisht në performancën energjitike të ndërtesave. Drafti me kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave është hartuar dhe dorëzuar nga AEE në MIE më datë 14.05.2020 jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 116/2016 për “Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 16 pika 1.
- Referuar PKVEE 2017-2020 fq. 26, MIE nuk ka hartuar Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave publike dhe Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji", të cilat duhej të realizoheshin deri më datë 31 dhjetor 2017. Mungesa e këtyre dy dokumenteve politike bën të pamundur zbërthimin në hapa konkrete të aktiviteteve që duhen ndërmarrë lidhur me këto dy çështje.
- Kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa kanë si qëllim të verifikojnë dhe kontrollojnë vlefshmërinë dhe saktësinë e të dhënave përkatëse përgatitur nga audituesit energjistikë. Kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e certifikatave që do të verifikohen, si dhe procesi i mbikëqyrjes së certifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa hartohen nga AEE dhe miratohen me VKM, me propozim të MIE.<sup>46</sup> Shkaku kryesor i mos miratimit me VKM është se Drafti për këto kritere dhe procedura është hartuar dhe dorëzuar nga AEE në MIE më datë 13.05.2020, jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 16 pika 1.
- Rregullorja e formatit të auditimit energjistik dhe pagesave për audituesin energjistik është hartuar nga AEE dhe është dërguar për miratim në MIE me shkresën me nr. Prot. 80 datë 15.05.2020. Afati për miratimin e kësaj rregulloreje ka qenë 25.11.2017.<sup>47</sup> Kjo rregullore ndihmon në parandalimin e abuzimeve që çdo person, subjekt i auditimit energjetik, paguan ndaj shpenzimeve të kryera nga audituesit energjistikë, si dhe shpenzimet për zbatimin e masave të dhëna nga audituesi për kursimin e energjisë.
- Mos miratimi nga Ministri i MIE i Udhëzimit mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit mbi informimin dhe trajnimin e palëve të interesit sipas përcaktimit të bërë në Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 15 pika 4, shkakton mos informimin korrekt të konsumatorëve fundorë për

---

<sup>46</sup> Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 13 pika 6.

<sup>47</sup> Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 16 pika 2.

metodat dhe praktikat e ndryshme, që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë si dhe në trajnimin e përfaqësuesve të institucioneve qendrore/vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë mbi legjislacionin për eficiencën e energjisë.

- Mungesa e një baze të dhënash kombëtare të përditësuar nga AEE, lidhur me konsumin final të energjisë dhe arritjet në kursimin bën të pa mundur vlerësimin e arritur të objektivave për eficiencën e energjisë të përcaktuara në Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”.
- Aty ku përdorimi i matësve individualë nuk është teknikisht i realizueshëm dhe aty ku ndërtesat me shumë apartamente furnizohen nga rrjeti i ngrohjes/ftohjes qendrore apo ku sistemet e ngrohjes/ftohjes janë të përbashkëta, AEE harton rregulla transparente për ndarjen e konsumit të energjisë termike te konsumatorët fundorë.<sup>48</sup> Mungesa e rregullave të përcaktimit të energjisë termike nga AEE, ndikon negativisht në konsumin e energjisë termike në konsumatorët fundorë.

### **Rekomandime**

- Ministri i MIE të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të saj.  
**Dhjetor 2020**
- Drejtori i Përgjithshëm i AEE të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të saj.  
**Dhjetor 2020**
- MIE në bashkëpunim me AEE të marrin masat për hartimin dhe propozimin në Këshillin e Ministrave të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes.  
**Dhjetor 2020**
- MIE të marrë masa për miratimin e “programit kompjuterik” bazuar në konceptet kryesore të MKLL.  
**2 muaj pas miratimit me VKM të MKLL**
- MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave “Procedurat dhe kushtet e çertifikimit të performancës së energjisë së ndërtesave dhe modelin, përmbajtjen, kushtet e regjistrimit të çertifikatës për performancën e energjisë të ndërtesave”.  
**Dhjetor 2020**
- MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave Kategoritë e ndërtesave që janë objekt përjashtimi referuar Ligjit nr.116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” neni 4 pika 6.  
**Dhjetor 2020**
- MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave “kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave”.

---

<sup>48</sup> Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, neni 14 pika 2.

## **Dhjetor 2020**

- MIE të marrë masat për të hartuar Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave Publike.

### **Me miratimin e PKVEE-së së ardhshme**

- MIE të marrë masat për të hartuar Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji" pjesë e PVKEE;

### **Me miratimin e PKVEE-së së ardhshme**

- MIE të propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave "kriteret dhe procedurat për mënyrën e përzgjedhjes dhe sasinë e çertifikatave që do të verifikohen, si dhe procesin e mbikëqyrjes së çertifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa".

## **Dhjetor 2020**

- Ministri i MIE të miratojë rregulloren e hartuar nga AEE "Për formatin e auditimit energjistik dhe pagesën për audituesin energjistik".

## **Tetor 2020**

- Ministri i MIE të miratojë Udhëzimin mbi llojin dhe periodicitetin e informacionit mbi informimin dhe trajnimin e palëve të interesit sipas përcaktimit të bërë në Ligjin 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë" neni 15 pika 2 dhe 3.

## **Dhjetor 2020**

- AEE të marrë masat në ngritjen e një baze të dhënash kombëtare të përditësuar, lidhur me konsumin final të energjisë dhe arritjet në kursimin e saj.

## **Në vazhdimësi**

- AEE të hartojë dhe të propozojë për miratim në MIE, Udhëzimin për rregullat e përcaktimit të konsumit të energjisë termike.

## **Dhjetor 2020**

### **3.1.2 A është zbatuar kuadri ligjor/rregullator nga institucionet përgjegjëse lidhur me Eficiencën e Energjisë?**

Një nga mënyrat kryesore për të plotësuar kushtet e përcaktuara nga dokumentat politike dhe kuadri ligjor lidhur me eficiencën e energjisë është termoizolimi i ndërtesave. Për të reduktuar humbjet për transmetimin e nxehtësisë jashtë ndërtesës duhet të modifikohen vetitë termike të ndërtesës (veçanërisht kapaciteti dhe përcjellshmëria). Muret dhe tarraca e izoluar, dritaret me xham me dy ose tre shtresa dhe me hapësirë ajri midis tyre janë karakteristikat kryesore të projektimit të një ndërtese eficiente në përdorimin e energjisë. Materialet izolues, vetitë termike të cilave i rezistojnë transmetimit të nxehtësisë dhe faktorëve atmosferike duhet të ndërfiten në projektet e ndërtesave të reja. Funkcionet tipike dhe të pazëvendësueshme të sistemit termoizolues janë:

- Izolim pa ndërprerje nga i ftohti dhe i ngrohti.
- Përdorim i fluksit termik të mbajtur nga paretet e izoluar.

- Mbrojtje e fasadave nga agjentët atmosferik.
- Kursime të ndjeshme të përdorimit të energjisë.
- Kushte më të mira ndaj lagështirës të strukturës së ndërtesave.
- Kushte optimale komforti dhe higjienike të hapësirave të banuara, të shërbimeve, etj.
- Ulje dhe minimizim i emisioneve ndotës në atmosferë.


### Avantazhet

Pas instalimit të sistemit termoizolues paretet e jashtëm të ndërtesave, të reja ose ekzistuese, nuk shpërndajnë më nxehtësinë jashtë, por zhvillojnë funksionin e rëndësishëm termik. Edhe në dimër, shkëmbimi i ajrit mund të bëhet pa patur nevojë të ndryshojmë temperaturën e ngrohjes: nxehtësia e thithur nga muret rigjeneron në mënyrë të shpejtë dhe homogjene kushtet me komfort. Kursimi për lëndën djegëse që përdoret për ngrohjen qoftë lëndë e ngurtë, e gaztë apo e lëngët, duke çuar në minimizimin e emisioneve të CO<sub>2</sub> dhe SO<sub>2</sub> në atmosferë, kontribuon në mënyrë të vazhdueshme në zgjidhjen e problemeve të ndotjes së mjedisit, edhe smogut. Për gjithë këto karakteristika të frytshme sistemi i termoizolimit gjen aplikim në tipologji të ndryshme përdorimi si ndërtesa redizenciale, shkollore, spitalore, tregtare, ushtarake, prodhuese, stokimi etj.

### Izolimi i mureve dhe çatave

Humbjet termike përgjatë mureve mund të arrijnë vlerën prej 50% të humbjeve totale, ndërsa humbjet nga çatia mund të arrijnë deri në 25%. Si rrjedhojë, izolimi i mureve dhe çatisë së një shtëpie është një mënyrë efektive për ta bërë shtëpinë më eficiente në energji.<sup>49</sup>

**Figura 1: Humbjet e energjisë në banesa**



Burimi: *Eficensa e energjisë në banesa*<sup>50</sup>

<sup>49</sup> <https://www.idpublications.org/wp-content/uploads/2015/12/Abstract-THERMAL-INSULATION-IN-URBAN-HOUSING-AND-THEIR-ECONOMIC-BENEFITS.pdf>

<sup>50</sup> Eficensa e energjisë në banesa, Altenergy, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, fq. 5

Aktualisht në vendin tonë nuk ka një koordinim të organizuar sa i përket iniciativave për rinovimin e ndërtesave me masa për përmirësimin e eficiencës së energjisë. Duke qenë se Ligji nr. 124/2015 për “Eficiencën e Energjisë dhe Ligji nr. 116/2016 për ” Performancën e Energjisë së Ndërtesave” nuk janë plotësuar me të gjitha aktet nënligjore përkatëse, sot në Shqipëri është e pamundur të realizohet një auditim energjitik për performancën e energjisë në ndërtesa në përputhje me këto dy ligje. Zbatimi me përpikmëri i këtyre ligjeve kërkon para së gjithash plotësimin e tyre me të gjitha aktet nënligjore nga vetë institucionet publike përgjegjëse si MIE dhe AEE. Kjo ka bërë që edhe nismat që qytetarët ndërmarrin për përmirësimin e performancës së energjisë në banesat e tyre të jenë sporadike, të paorganizuara, të pambështetura financiarisht me qëllim kursimin e energjisë dhe faturave energjitike. Rinovimet në godinat (veçanërisht ato private) kryhen nga njerëz apo edhe kompani të paçertifikuara nga insitucionet përkatëse (AEE), ndërkohë që duhet të kryhen nga shoqëri të shërbimeve energjitike referuar Ligjit nr. 124/2015 për “Eficiencën e Energjisë” neni 18. Rezultati i rinovimeve aktuale të masave me qëllim përmirësimin e eficiencës së energjisë është i pamatshëm, i padukshëm dhe i paqartë për atë kohë sa nuk kryhen raporte të auditimit energjitik para dhe pas rikonstruksionit të ndërtesave. E njëjta problematikë vihet re edhe në rinovimet e ndërtesave publike, referuar investimeve të godinave publike dhe e trajtuar nga grupi i auditimit më në detaje në pyetjen audituese 3.2.2.

## Gjetje

- AEE nuk ka monitoruar zbatimin e PKVEE 2017-2020.
- Ministri i MIE nuk ka miratuar një Urdhër të veçantë mbi formën dhe shpeshësinë e paraqitjes së raportimit të PKVEE 2017-2020.
- Ministri i MIE nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e PKVEE 2017-2020.
- Deri më sot në Shqipëri nuk është bërë asnjë auditim energjitik dhe nuk është lëshuar asnjë certifikatë e performancës së energjisë në përputhje me Ligjin nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave”.
- Për periudhën 2016-2019 nuk është bërë certifikimi për asnjë auditues energjitik.
- Urdhëri i Kryeministrit me nr. 56 datë 20.04.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Agjencisë për Eficiencën e Energjisë” nuk është zbatuar.
- Deri më sot nuk është lidhur asnjë marrëveshje vullnetare midis AEE dhe Konsumatorëve të mëdhenj të energjisë (KME).
- AEE nuk ka ndërmarrë masa për vënien në zbatim të faturave të energjisë që përmbajnë:
  - krahasime në formë grafike mbi konsumin e vitit aktual me atë të mëparshëm,
  - këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente;

- numrin jeshil pa pagesë.<sup>51</sup>
- AEE nuk ka ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi dhe nuk ka informuar konsumatorët fundorë për metodat dhe praktikat e ndryshme, që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë.
- AEE nuk ka organizuar trajnime për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë mbi legjislacionin për eficiencën e energjisë, si dhe për masat për implementimin e këtij legjislacioni.
- AEE nuk ka kryer sondazhe mbi të dhënat e konsumit të energjisë në sektorët rezidencialë, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë.
- AEE nuk ka patur në strukturën organizative të saj një sektor të posaçëm lidhur me informacionet dhe statistikën.
- AEE nuk ka patur në strukturën e saj nëpunës të autorizuar.
- AEE gjatë periudhës objekt auditimi nuk ka aplikuar asnjë kundravajtje administrative referuar Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 26 pika 1 dhe Ligjit nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 15 pika 1.

## Konkluzione

- AEE është institucioni përgjegjës për të monitoruar dhe raportuar në MIE mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Eficiencës së Energjisë.<sup>52</sup> Që nga momenti i themelimit të AEE-së e deri në 2019, ajo asnjëherë nuk ka monitoruar dhe raportuar në MIE mbi zbatimin e masave dhe objektivave të vendosura në PKVEE 2017-2020. Formatit mbi mënyrën e raportimit të AEE-së në MIE nuk është miratuar me Urdhër të veçantë nga Ministri i MIE dhe kjo është një nga shkaqet kryesore të mos raportimit.
- Në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 8 pika 5, Ministri i MIE duhet të raportojë çdo vit në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë. Për periudhën objekt auditimi, Ministri i MIE nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e PKVEE.
- Mungesa e realizimit të auditimeve energjitike (për periudhën 2016-2019) në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” i *ndryshuar*, ka ardhur si rezultat i mungesës së Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes për performancën energjitike të ndërtesave si dhe mungesës së audituesve energjitikë të certifikuar. Mungesa e auditimeve energjitike sjell mangësi dhe në rritjen e standarteve të performancës në auditimin e energjisë në ndërtesa nëpërmejt një vlerësimi të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik. Vlen për t’u përmendur se AEE ka realizuar testimin e

<sup>51</sup> PKVEE 2017-2020, fq 110.

<sup>52</sup> Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 8 pika 1 & 4.

parë për çertifikimin e audituesve energjitikë në 22.05.2020 dhe shumë shpejt pritet pajisja e audituesve energjitikë me çertifikata.

- Urdhëri i Kryeministrit me nr. 56 datë 20.04.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të Organikës së Agjencisë për Eficiencën e Energjisë” ka të përcaktuar organikën dhe strukturën e AEE-së sipas të cilës numri i punonjësve të AEE-së duhet të jetë 10 veta. Aktualisht, si pasojë e mungesës së fondeve, numri i stafit në total në AEE është 6, dhe kjo mangësi në kapacitete humane ndikon dhe cënon në zbatimin me efektivitet të të gjithë objektivave të AEE-së.
- Marrëveshjet vullnetare lidhen ndërmjet Agjencisë për Eficiencën e Energjisë dhe Konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, për dhënien e mbështetjes për marrjen dhe zbatimin e masave për eficiencën e energjisë.<sup>53</sup> Bazuar në Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 4 pika 15, “Konsumator i madh i energjisë” (KME) është një konsumator fundor, i cili, në bazë të të dhënave të një **procesi auditimi**, rezulton se ka konsum vjetor të energjisë më të madh se ekuivalenti i 3 milionë kWh në vit. Duke qenë se deri më sot nuk është kryer asnjë auditim energjitik që janë të nevojshme për të përcaktuar KME pasi MKLL nuk është miratuar me VKM dhe në mungesë të audituesve të çertifikuar, AEE nuk ka lidhur asnjë marrëveshje vullnetare me konsumatorët e mëdhenj të energjisë.
- Faturimi informativ, fushatat e ndërgjegjësimit, edukimi dhe trajnimi për eficiencën e energjisë janë disa nga masat kryesore lidhur me kursimin e energjisë të cilat janë përgjegjësi direkte e AEE-së referuar PKVEE 2017-2020 (fq. 110). Faturat duhet të përmbajnë krahasime, në formë grafike, të konsumit në periudhën e faturimit të vitit aktual dhe konsumit në periudhën korresponduese të vitit të mëparshëm. Faturat duhet të bazohen në konsumin aktual dhe duhet të përmbajnë informacion se ku mund të merren këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente, duke vendosur një numër telefoni jeshil (pa pagesë). AEE nuk ka ndërmarrë asnjë masë lidhur me faturimin informativ si dhe fushatave të ndërgjegjësimit dhe informimit të konsumatorëve fundorë.
- Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 15 pika 3 ngarkon AEE me përgjegjësinë për organizimin e trajnimeve për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë mbi legjislacionin për eficiencën e energjisë. Për periudhën objekt auditimi, AEE nuk ka realizuar asnjë trajnim me aktorët e sipërpërmendur.
- Kryerja e sondazheve nga AEE mbi konsumin e energjisë nga konsumatorët e sektorëve rezidencialë, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë, është me shumë rëndësi sa i përket të dhënave kombëtare që AEE duhet të disponojë. Mos kryerja e sondazheve të tilla nga AEE ka ndikuar në mungesën

---

<sup>53</sup> Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 12 pika 1.

e të dhënave kombëtare të përditësuara, lidhur me konsumin final të energjisë dhe arritjet në kursimin saj.

- Në PKVEE 2017-2020 është parashikuar që në strukturën e AEE-së të ketë një sektor të posaçëm, detyra e të cilit do të jetë Informacioni dhe Statistika. Në strukturën organizative të AEE nuk ka patur një sektor lidhur me informacionet dhe statistikat duke sjellë mos realizimin e objektivave që ky sektor duhet të mbulojë.
- Nëpunësit e autorizuar të AEE-së duhet të jenë auditues energjitikë të çertifikuar, të cilët nuk kanë të drejtë të ushtrojnë këtë profesion jashtë kësaj agjencie. Ata verifikojnë “Çertifikatën për performancën e energjisë” për ndërtesën apo njësinë e saj të dhënë nga audituesi energjitik (privat) duke realizuar Raportin e mbikëqyrjes. Mungesa e Çertifikimit të audituesve energjitikë ka sjellë mungesë të nëpunësve të autorizuar në institucionin e AEE-së.
- AEE bazuar në Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” dhe Ligjin nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” është institucioni publik i cili ka përgjegjësinë për vendosjen e sanksioneve kundrejt shkelësve të ligjeve të sipërcituar. Mos marrja e masave sanksionuese nga ana e AEE-së ka ardhur si rezultat i mos plotësimit të dy ligjeve të përmendura më sipër me aktet nënligjore të përcaktuara në secilin prej tyre. Mungesa e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, mungesa audituesve energjitikë të çertifikuar, mungesa e raporteve të auditimit energjitikë dhe mungesa e çertifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa (për periudhën objekt auditimi) janë disa nga pengesat kryesore që e bëjnë të pamundur aplikimin e kundravajtjeve administrative nga AEE.

## **Rekomandime**

- AEE të monitorojë zbatimin e PKVEE 2017-2020 dhe PKVEE pasardhëse.  
**Në vazhdimësi**
- Ministri i MIE të miratojë një Urdhër të veçantë mbi formën dhe shpeshhtësinë e paraqitjes së raportimit të PKVEE.

### **Tetor 2020**

- Ministri i MIE të raportojë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e PKVEE 2017-2020 dhe çdo vit për PKVEE-të pasardhëse.

### **Dhjetor 2020 dhe në vazhdimësi**

- Pas miratimit me VKM të MKLL-së dhe çertifikimit të audituesve energjitikë AEE të marrë masa për vënien në zbatim të plotë të Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” dhe Ligjit nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” me qëllim realizimin e auditimeve energjitike.

### **Në vazhdimësi**

- Pas përcaktimit të Konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, AEE të shikojë mundësinë për lidhjen e marrëveshje vullnetare me ta.

## Në vazhdimësi

- AEE të ndërmarrë masa për vënien në zbatim të faturave të energjisë që përmbajnë:
  - krahasime në formë grafike mbi konsumin e vitit aktual me atë të mëparshëm,
  - këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente;
  - numrin jeshil pa pagesë.

## Dhjetor 2020 dhe në vazhdimësi

- AEE të ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi duke informuar konsumatorët fundorë për metodat dhe praktikrat e ndryshme, që shërbejnë për të rritur performancën e energjisë.

## Dhjetor 2020 dhe në vazhdimësi

- AEE të marrë masa për të organizuar trajnime për përfaqësuesit e institucioneve qendrore, vendore, audituesit e energjisë, si dhe menaxherët e energjisë mbi legjislacionin për eficiencën e energjisë.

## Mars 2021 dhe në vazhdimësi

- AEE të realizojë sondazhe mbi të dhënat e konsumit të energjisë në sektorët rezidencialë, shërbimeve, industrisë, transportit dhe bujqësisë.

## Mars 2021 dhe në vazhdimësi

- AEE të marrë masa për të iniciuar ndryshime në strukturën organizative të saj duke krijuar një sektor të posaçëm lidhur me informacionet dhe statistikat.

## Dhjetor 2020

- AEE të marrë masa për përfshirjen në strukturën e saj të nëpunësve të autorizuar në përputhje me Ligjin nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 13 pika 3.

## 6 muaj pas procesit të parë të certifikimit të audituesve energjistikë

- AEE të marrë masa për aplikimin e kundravajtjeve administrative referuar Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” neni 26 pika 1 dhe Ligjit nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 15 pika 1 pasi të gjenerohen “Çertifikatat e Performancës së Energjisë në Ndërtesa” nga audituesit energjistikë.

## Në vazhdimësi

### 3.2 A ka qenë e mjaftueshme mbështetja financiare për të arritur objektivat në fushën e EE?

#### 3.2.1 A ekzistojnë mekanizma financiare për të siguruar rritjen e Eficiencës së Energjisë?

Masat e parashikuara për nxitjen dhe promovimin e përdorimit eficient të energjisë për të arritur objektivin kombëtar *reduktimin me 6.8% të kërkesave për energji deri në vitin 2020*, të përcaktuar në PKVEE 2017-2020 dhe në SKE 2018-2030, duhet të kishin mbështetjen e duhur financiare për të siguruar zbatimin dhe monitorimin e

sukseshëm të tyre. Sikurse Grupi i Auditimit (G.A) e ka evidentuar edhe në kapitullin “Pesha në buxhet”, zbatimi i masave të parashikuara për EE, për investimet të nevojshme në sektorin publik për periudhën 2018- 2020, duhet të mbështetej me një buxhet prej 140 milion euro, ose rreth 17.2 miliard lekë<sup>54</sup>.

Referuar SKE 2018-2030, masat e ndërmarra gjatë zbatimit të PKVEE-së së parë për përdorimin eficient të energjisë, janë financuar kryesisht me buxhet të huaj, por numri në rritje i masave për eficiencën e energjisë, kërkon që të rriten njëkohësisht edhe fondet e brendshme (publike dhe private) për EE-në.”<sup>55</sup> Për shkak se SKE 2018-2030 nuk është shoqëruar me një plan masash të kostuar vit pas viti për EE, apo PKVEE 2017-2020 nuk është përditësuar me publikimin e këtij dokumenti strategjik, G.A ka kryer analiza e mëposhtme duke ju referuar totalit të buxhetit të nevojshëm të publikuar në Strategji, për periudhën 2018-2020.

**Tabela 8: Buxheti i nevojshëm për zbatimin e masave në EE sipas SKE 2018-2030, buxheti i planifikuar dhe ai i alokuar.**

000/ lekë

Buxheti /Viti	2016	2017	2018	2019	2020	Totali <sup>56</sup>
SKE 2018-2030	N/A	N/A	17.2 milion			17.2 milion
Buxheti i parashikuar në BSH (faktik)	313,604	561,400	502,751	726,207	N/A	1.2 milion <sup>57</sup>
Buxheti i alokuar (realizuar)	269,704	109,104	236,812	N/A	N/A	-
Niveli i realizimi të buxhetit faktik	86%	19%	47%			

Burimi: MIE

Përpunoi: G.A

Nga analizat e të dhënave financiare të kryera nga G.A, evidentohet se në total përgjatë periudhës 2018-2019, investimet e parashikuara në buxhetin e shtetit për EE arrijnë në vlerën 1.2 miliardë lekë. Rreth 31% e këtyre fondeve ishin financim i brendshëm, ndërsa 69% financim i huaj. Sikurse evidentohet edhe në tabelën e mësipërme, fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për të mbështetur EE gjatë periudhës 2018-2019 janë ndjeshëm më të ulëta se fondet e planifikuara në SKE për zhvillimin e këtij nënsektori deri në vitin 2020. Edhe më e ndjeshme është diferenca kur vlerësojmë buxhetin e alokuar kundrejt atij të parashikuar në BSH për tu akorduar. Niveli i mosrealizimit të buxhetit është në nivele të larta, duke thelluar hendekun midis fondeve të nevojshme dhe atyre të angazhuara për EE. Sikurse trajtohet në vijim, pamjaftueshmëria e fondeve të investuara në EE ka dhënë pasoja në krijimin dhe

<sup>54</sup> Konvertuar me kursin mesatar vjetor të këmbimit për vitin 2019, 1Euro=122.975 lekë, publikuar nga Agjencia për Tregti dhe Zhvillim e Kombeve të Bashkuara.

<sup>55</sup> Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030, fq. 52

<sup>56</sup> Totali i buxhetit, pas publikimit të SKE 2018-2030

<sup>57</sup> Totali për vitin 2018 & 2019.

funkcionimin e AEE-së dhe Fondit EE, dy prej strukturave më të rëndësishme për zhvillimin e këtij nënsektorit, me rol kyç si në zbatimin dhe monitorimin e masave dhe projekteve në këtë fushë, ashtu edhe në sigurimin e fondeve të tjera nëpërmjet marrëveshjeve, apo mekanizmave të ndryshëm financiar.

## Gjetje

- Fondet e planifikuara në buxhetin e shtetit për periudhën 2018-2019 janë rreth 14 herë më pak se fondet e nevojshme për të zbatuar aktivitetet e parashikuara për EE në Strategjinë Kombëtare të Energjisë deri në vitin 2020<sup>58</sup>.
- Niveli i realizimit të fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit për EE, për vitin 2017, ishte 19%.
- Në 2018, fondet e alokuara për eficiencën e energjisë ishin rreth 53% më pak se fondet e planifikuara në buxhetin e shtetit.
- Për vitin 2019, grupi i auditimit arriti të analizojë vetëm nivelin e realizimit të financimeve të brendshme, i cili ishte në nivelin 58%.
- Nga të dhënat e konsultuara nga G.A, vënë në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MIE, mosrealizimi i buxhetit ka ardhur si rezultat i vonesave të lidhura me projektet e huaja (kujtojmë se EE është financiar kryesisht me fonde të huaja), si: vonesa në lidhjen e marrëveshjeve financiare, vonesa në nxjerrjen e lejeve të ndërtimit, etj.
- Në qershor 2020, MIE ende nuk ka të dhëna zyrtare mbi nivelin e realizimit të financimeve të huaja për projektet në EE gjatë vitit 2019.<sup>59</sup> Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, ende nuk ka marrë të informacione nga Drejtuesi i Ekipit të Projekteve të Energjisë mbi nivelin e realizimit të buxhetit për fondet e huaja, për vitin 2019.

## Konkluzione

- Nga sa më sipër, grupi i auditimit konkludon se masat për të siguruar përparim në drejtim të përdorimit eficient të energjisë në vend, me qëllim për të arritur objektivin kombëtar të kursimit, nuk janë mbështetur me buxhetin e nevojshëm.
- Niveli i realizimit të buxhetit (faktik) gjatë periudhës nën auditim është në nivele të ulta, çka ka shkaktuar që, pavarësisht shtimit të masave të parashikuara për EE, buxheti i alokuar në vitin 2018 të ishte më i ulët, se ai i alokuar në vitin 2016.
- Niveli i lartë i mosrealizimit është shkaktuar nga vonesa të lidhura me projektet e huaja, çka ka shkaktuar edhe mosrealizimin e fondeve të

---

<sup>58</sup> Shënim i G.A: Në këtë llogaritje nuk është përfshirë viti 2020.

<sup>59</sup> Udhëzimi standard nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" dhe Udhëzimi Nr. 22 datë 17/11/2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit.

brendshme, TVSH-së për këto projekte. Si rezultat se në raportet vjetore të monitorimit të zbatimit të buxhetit, nuk janë trajtuar në mënyrë shteruese shkaqet e lidhura me mosrealizimin e buxhetit, grupi i auditimit e ka të pamundur të identifikojë problematikat dhe përgjegjësit për çdo projekt të realizuar jo-plotësisht.

- Referuar Udhëzimit nr. 9<sup>60</sup> të MFE dhe Udhëzimit nr. 22<sup>61</sup> të MFE, Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor (DEMP) duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit me shifra dhe narrative, duke sqaruar ecurinë e realizimit të projekteve me qëllim realizimin e objektivave të programit, brenda muajit shkurt të viti pasardhës të përfundimit të vitit buxhetor. Për shkak se MIE ende nuk ka të dhëna zyrtare mbi nivelin e realizimit të financimeve të huaja për vitin 2019, G.A (si dhe vet MIE) e ka të pamundur të analizojnë realizimin e buxhetit për fondet huaja për 2019, të vlerësojë ecurinë, apo të japë rekomandime për përmirësim.

## **Rekomandime**

- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në MIE të kostojë aktivitetet që duhet të ndërmerren në përmbushje të objektivave të parashikuara në SKE dhe PKVEE për eficiencën e energjisë.

### **Dhjetor 2020**

- Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor (DEMP) të Energjisë, të trajtojnë në mënyrë të detajuar, në raportet vjetore të monitorimit që përgatit mbi realizimin e buxhetit, shkaqet dhe përgjegjësit për mosrealizimin për çdo rast.

### **Në vazhdimësi**

- MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar buxhetimin faktik për eficiencën e energjisë, në mbështetje të aktiviteteve të kostuara për të garantuar përmbushjen e objektivave të SKE dhe PKVEE.

### **Në vazhdimësi**

- MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për realizimin buxhetit për eficiencën e energjisë, në përputhje me buxhetin faktik.

### **Në vazhdimësi**

- Drejtuesi i Ekipit të Projekteve të Energjisë të përgatisë dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit me shifra dhe narrativ, për vitin 2019.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

---

<sup>60</sup> Udhëzimi standard nr.9, datë 20.07.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

<sup>61</sup> Udhëzimi Nr. 22 datë 17/11/2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit.

### **Agjencia për Eficiencën e Energjisë**

Agjencia për Eficiencën e Energjisë është institucioni përgjegjës për promovimin dhe ndjekjen e zbatimit të masave e të politikave të eficiencës së energjisë. Kjo Agjenci ka një rol thelbësor për zhvillimin e nënsektorit të Eficiencës së Energjisë. Ajo përgatit dhe propozon aktet e nevojshme nënligjore për nxitjen e eficiencës së energjisë, përgatit dhe monitoron Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, kryen testimet për çertifikimin e audituesve energjitikë, krijon dhe përditëson bazën e të dhënave kombëtare lidhur me konsumin final të energjisë dhe arritjet në kursimin saj, vlerëson teknikisht projektet e investimeve në fushën e eficiencës së energjisë, koordinon programet e eficiencës së energjisë, të financuara nga institucionet ose organizatat ndërkombëtare, mbështetur në marrëveshjet qeveritare, kryen fushata të ndërgjegjësimit publik, etj<sup>62</sup>.

“Vënia në funksionim të plotë të AEE është qartazi prioritet i qeverisë bazuar në SKE 2018-2030”.<sup>63</sup> Si i tillë, në Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë, AEE ishte planifikuar të fillonte veprimtarinë e saj në vitin 2017. Nga vlerësimet e kryera në PKVEE 2017-2020, buxheti i nevojshëm për krijimin dhe funksionimin e AEE-së për periudhën 2017-2020, ishte 345 milionë lekë.<sup>64</sup> Sipas kostimit paraprak të aktiviteteve, parashikohej që buxheti total i Agjencisë për vitin e parë të veprimit (referuar Planit: viti 2017) të ishte 120 milionë lekë, ku një pjesë do të shkonte për infrastrukturën e pajisjeve të punës dhe pjesa tjetër kosto operacionale. Ndërsa, pas vitit të parë funksionimi i saj do të kushtonte rreth 68 milion lekë/vit.

Grupi i auditimit analizoi alokimin e fondeve për periudhën 2017-2019 për Agjencinë e Eficiencës së Energjisë. Kjo Agjenci është ngritur me VKM nr. 852 dt. 07.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë”.

**Tabela 9: Fondet e alokuara për AEE kundrejt fondeve të nevojshme (000 lek)**

<i>Fondet për AEE/Vitet</i>	<i>2017</i>	<i>2018</i>	<i>2019</i>	<i>Totali</i>
<i>Fondet e nevojshme sipas PKVEE</i>	120 000	68 000	68 000	256 000
<i>Fondet e alokuara</i>	-	85 000	29 854	114 850

Burimi: Të dhënat financiare AEE 2018-2019 & PKVEE 2017-2020  
Përpunoi: G.A

AEE ka nisur realisht të funksionojë në vitin 2018. Në këtë vit, janë alokuar fondet për infrastrukturën e pajisjet e punës (82 milion lekë) dhe pjesa tjetër shpenzime pagash dhe sigurimesh shoqërore (3 milion lekë). Sipas të dhënave financiare, fondet e alokuara në vitin 2018 ishin rreth 30% më pak se ato të parashikuara në PKVEE, për vitin e parë të funksionimit të AEE-së. Në vitin 2019, buxheti i alokuar për këtë

<sup>62</sup> Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, neni 7, 8, 13, 14, 15, 25.

<sup>63</sup> Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030, fq. 34.

<sup>64</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë, 2017-2020, fq 42.

institucion ishte rreth 56% më pak se buxheti i nevojshëm për funksionimin e tij dhe realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planit Kombëtar të Veprimit.

Referuar PKVEE 2017-2020, *buxheti i planifikuar në PBA për AEE për periudhën 2017-2019 nuk mbulon plotësisht shpenzimet për funksionimin e AEE-së*<sup>65</sup>. Buxheti i alokuar për këtë periudhë është edhe më i ulët, se planifikimi të cilit i referohet PKVEE 2017-2020. Nga takimet dhe intervistat zyrtare të kryera, AEE tregon se gjatë periudhës qershor-shtator 2019 institucioni ka patur pamundësi për të paguar pagat dhe sigurimet e punonjësve të saj ekzistues apo të plotësojë strukturën me staf, për shkak të mungesës së fondeve.<sup>66</sup>

*“AEE ka marrë sanksione si rezultat i detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara, dhe kjo ka ardhur për shkak të pamjaftueshmërisë së fondeve për t’i paguar ato”*<sup>67</sup> Sipas stafit, *buxheti ka qenë i pamjaftueshëm për të siguruar funksionimin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit.*<sup>68</sup> Disa prej aktiviteteve të cilat AEE liston se janë përmbushur në mënyrë të pjesshme, si rezultat i mungesës së fondeve dhe kapaciteteve janë monitorimi i PKVEE 2017-2020, grumbullimi dhe krijimi i bazës së të dhënave të EE, fushatat e ndërgjegjësimit, etj. Gjithashtu, në intervistën zyrtare të realizuar me AEE, institucioni shprehet se mosfunksionimi i Fondit EE, ka çënuar një sërë aktiviteteve që Agjencia duhet t’i kryej me mbështetjen e këtij Fondi, si. p.sh. lidhja e Marrëveshjeve Vullnetare, etj.<sup>69</sup>

## **Gjetje**

- Në vitin 2017 nuk janë alokuar fonde për AEE, megjithëse ky institucion është krijuar në vitin 2016<sup>70</sup>.
- Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i alokuar për AEE është rreth 55% më pak se buxheti i nevojshëm për funksionimin e plotë të këtij institucioni, referuar PKVEE 2017-2020.
- Në vitin 2019, AEE ka marrë gjobë nga Drejtoria e Tatimeve në vlerën 43.684 lekë, për mospagimin në kohë të detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të saj. Pamjaftueshmëria e fondeve të alokuara për AEE ka ndikuar në mosmbulimin e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të saj.

## **Konkluzione**

- Funksionimi i plotë i AEE-së, si një aktor kyç për zhvillimin dhe nxitjen e Eficiencës së Energjisë në vend, gjatë periudhës nën auditim nuk është trajtuar

---

<sup>65</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2016-2020, fq 42.

<sup>66</sup> Përgjigja e intervistës zyrtare – AEE, pyetja 4.

<sup>67</sup> Përgjigja e intervistës zyrtare – AEE, pyetja 3.

<sup>68</sup> Përgjigja e intervistës zyrtare – AEE, pyetja 2.

<sup>69</sup> Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, neni 12, pika 3.

<sup>70</sup> VKM nr. 852 dt. 07.12.2016 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë”.

si prioritet kombëtar në aspektin financiar. Mbështetja me buxhet ka qenë e pamjaftueshme, duke cënuar efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së AEE-së.

### **Rekomandime**

- AEE në bashkëpunim me MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të kostuar aktivitetet që ky institucion duhet të kryejë, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe rregullatore.

#### **Dhjetor 2020**

- MIE të ndërmarrë masat e nevojshme për të alokuar buxhetin për AEE, mbështetur në rezultatet e kostimit të aktiviteteve, me qëllim funksionimin e plotë të AEE.

#### **Në vazhdimësi**

### ***Fondi për Eficiencën e Energjisë***

Fondi për Eficiencën e Energjisë është person juridik, me statusin e organizatës jofitimprurëse, i cili ka për qëllim dhënien e mbështetjes financiare në rastet e kryerjes së investimeve për marrjen e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë.<sup>71</sup> Fondi ishte menduar të mbështetej në parimet e vetëfinansimit, partneritetit dhe bashkëpunimit me sektorin privat për bashkëfinansimin e projekteve të investimeve për eficiencën e energjisë, etj. Në Planin Kombëtar të Veprimit për EE, një ndër masat kryesore ishte krijimi dhe funksionimi i Fondit të Efikasitetit të Energjisë. Sa më lart, fondi do të mbështeste edhe zbatimin e masave të parashikuara në PKVEE. Financimi total i nevojshëm, për funksionimin e Fondit për periudhën 2017-2020 ishte 250 milion lekë.<sup>72</sup> Përfituesit e Fondit do të ishin shoqëritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji, konsumatorët fundorë, shoqëritë e shërbimeve energjetike dhe siguruesit e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë, etj. FEE do të finançohej kryesisht nëpërmjet fondeve të përfituara nga marrëveshjet me donatorë të ndryshëm, fonde nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat nga aktivitetet e tij dhe shërbimet e ofruara.

Referuar Ligjit nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, FEE do të përdorej për financimin e programeve të mëposhtme (në përputhje me PKVEE 2017-2020):

- investimet që synojnë përmirësimin e efikasitetit të energjisë në konsumatorët fundorë;
- investimet që synojnë përmirësimin e efikasitetit të energjisë në prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë;
- përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndriçimin publik;
- përmirësimin e efikasitetit të energjisë në furnizimin me ujë dhe sistemet e trajtimit të ujërave të zeza;

<sup>71</sup> Ligji nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, neni 19, pika 1 & 2.

<sup>72</sup> Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2017-2020, fq.41 & 47.

- zhvillimin e projekteve pilot, me qëllim për të studiuar dhe testuar teknologji të reja të energjisë ose zgjidhje të reja organizative për sektorin e energjisë;
- auditimet e energjisë që do të kryhen në sektorin publik;
- përmirësimin e matjes dhe informacionit në faturim;
- kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e eficiencës së energjisë;
- fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitetet e edukimit në lidhje me eficiencën e energjisë;
- programet që financohen në kuadër të marrëveshjeve vullnetare, të propozuara nga Agjencia, etj.

Sipas Strategjisë Kombëtare për Energjinë 2018-2030, FEE do të përdorej për<sup>73</sup>:

- financimin e drejtpërdrejtë dhe promovimin e programeve për përmirësimin e eficiencës së energjisë,
- për fuqizimin e kompanive të shërbimeve energjetike;
- për të licencuar dhe aftësuar ekspertët e pavarur të energjisë dhe audituesit energjetikë;
- për të kryer auditimin e energjisë te kompanitë publike të shpërndarjes së energjisë, operatorët e sistemit të shpërndarjes, kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë;
- aftësimin bashkëkohor dhe instalimin e pajisjeve me eficiencë të lartë; etj.

FEE në bashkëpunim me AEE do të mbështesnin zhvillimin e mekanizmave financiar dhe fiskal për të nxitur investimet në EE, si:<sup>74</sup>

- Grantet për investime me kosto të ulët të EE-së për grupet në nevojë;
- Grantet për auditime energjetike të ndërtesave rezidenciale shumëkatëshe, shërbimeve komerciale dhe të industrisë;
- Kreditë me norma interesi më të ulëta nga institucione financiare ndërkombetare për investimin e EE-së në ndërtesat publike;
- Studime të hollësishme mbi mekanizmat e përshtatshëm fiskalë për të mbështetur investimet e EE-së, veçanërisht në lidhje me uljen e TVSH-së për investimet e zgjedhura të EE-së;
- Skemat specifike të financimit për grupet e familjeve në nevojë (me të ardhura të vogla) (p.sh. një mekanizëm “Paguani investimin duke kursyer”);
- Studime të hollësishme mbi varfërinë energjetike dhe përballueshmërinë financiare të shërbimit të energjisë; etj.

Krijimi i FEE është parashikuar në Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, më pas në PKVEE 2017-2020 dhe më vonë në Strategjinë Kombëtare të Energjisë në vitin 2018-2020. Megjithatë, referuar dokumentacionit të venë në dispozicion G.A-së,

<sup>73</sup>Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030, fq. 29.

<sup>74</sup> Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030, fq. 29-30.

si dhe intervistave të kryera FEE nuk është ngritur asnjëherë, dhe rrjedhimisht nuk janë përmbushur funksionet e parashikuara për të në kuadrin ligjor (të trajtuara më lart). Arsyeja e moskrijimit të tij, referuar intervistave zyrtare të kryera me stafin e MIE, është mungesa e fondeve.

Në Raportin e vlerësimit 2019 të Komisionit Evropian për vendin tonë, në Sektorin e Energjisë rekomandohet që gjatë vitit të ardhshëm, *“Shqipëria duhet vecanërisht të për afrojë plotësisht ligjin e eficientës së energjisë me acquis, të ngrejë Fondin e Eficientës së Energjisë dhe të hartojë dhe miratojë legjislacionin detyësor për zbatimin e direktivës së performancës së energjisë në ndërtesa.”*<sup>75</sup>

Nga materialet e shqyrtuara nga G.A, ish-Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka hartuar një draft VKM për Krijimin dhe Funksonimin e Fondit EE (dhjetor 2016), si dhe Manualin e Procedurave për Funksonimin e tij, të cilat nuk janë të miratuara. Në relacionin e përgatitur për Draft VKM theksohet nevoja e krijimit të fondit *për të hequr barrierat për financimin e projekteve që kanë synim eficientën e energjisë në sektorët e Ndërtesave, Shërbimeve, Industrisë, Transportit dhe Bujqësisë.*<sup>76</sup> Referuar këtyre dokumenteve, FEE do të financohej nga burime të ndryshme si: kredi nga institucionet ndërkombëtare financiare, kredi nga qeveri te vendeve te huaja; grante nga institucione ndërkombëtare financiare; grante nga qeveri te vendeve te huaja; fonde nga Qeveria Shqiptare; fonde nga përfituesit lokale (publike ose private); fonde nga marrëveshjet e lidhura me Ministri ose institucione te ndryshme brenda vendit; etj.<sup>77</sup>

Aktualisht, sikurse u trajtua edhe më herët, projektet në EE në vendin tonë janë financuar kryesisht me fonde të huaja, të tipit grante, (në vitin 2019 rreth 80% e fondeve te planifikuara për EE ishin grante) dhe fonde nga QSH. Krahasuar me burimet prej nga do të financohej Fondi (si: kredi nga institucione financiare vendase apo te huaja, fonde nga përfitues lokal, etj.), si rezultat i mungesës se këtij të fundit, një pjesë e mire e alternativave të financimit nuk janë shfrytëzuar. Nga konsultimi i një sërë praktikash të mira rezulton se, Fondi i Eficientës është një strukturë e cila përdoret gjerësisht në Evropë dhe rajon për të mbështetur financiarisht projektet në EE-së (si në: Kroaci, Kosovë, Serbi, Bullgari, Ukrainë, Poloni, Lituani, Mbretërinë e Bashkuar, etj.) Kjo për arsye se, si rezultat i sigurimit të fondeve nga burime të ndryshme, Fondi krijon një model më të qëndrueshëm financimi për projektet në EE, se ai i mbështetur kryesisht në donacione të huaja.<sup>78</sup> Si rezultat i përdorimi të Fondit, vendet e mësipërme raportojnë uljen e kostove të energjisë, ulje të nivelit të

---

<sup>75</sup> Komisioni Evropian: “Mbi gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2019”, fq. 20.

<sup>76</sup> Relacion, Draft-VKM për Krijimin e Fondit EE.

<sup>77</sup> Draft-Manualin e Procedurave për Funksonimin e FEE, fq.38.

<sup>78</sup> Instituti për Politikën Zhvillimore, Kosovë: “Financimi i Eficientës së Energjisë në Kosovë: përfitimet dhe pengesat”, 2015, fq. 8.

emetimeve të gazeve, etj.<sup>79</sup> Fondi vlerësohet si një iniciativë afatgjatë për të financuar rinovimin e ndërtesave. “Përvoja e vendeve evropiane si Polonia ose Lituania tregon se, Fondi mund të bëhet një zgjidhje gjithëpërfshirëse për modernizimin e energjisë në të gjithë sektorin e strehimit.”<sup>80</sup> Për përdoruesin e fundit që kërkon të bëjë rinovim të plotë të shtëpisë për përdorim eficient të energjisë, ekzistenca e FEE mundëson ofrimin e shërbimeve të tilla me kosto më të ulët për të. Në fakt, ky duket të jetë opsioni i vetëm i mundshëm për individët/familjet me të ardhura të ulëta. Për më tepër mbi përdorimin e Fondit nga vendet të ndryshme të Evropës, konsultoni Aneksin 1.

### **Gjetje**

- Fondi i Eficiencës së Energjisë i parashikuar në Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë” Kreu V, nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar ndonjëherë.

### **Konkluzione**

- Mosfunksionimi i Fondit ka çënuar financimin e programit në fushën e EE, zhvillimin e projekteve pilot për të studiuar teknologji të reja, kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e eficiencës së energjisë, ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese, zhvillimin e mekanizmave financiar dhe fiskal për nxitjen e investimeve, etj.
- Për shkak të rëndësisë që Fondi EE ka për zhvillimin e këtij nënsektori, ngritja dhe funksionimi i tij duhet të ishte trajtuar me prioritet nga Ministri i MIE, si struktura më e lartë drejtuese përgjegjëse për nxitjen, promovimin dhe përmirësimin e përdorimit eficient të energjisë. Mungesa e këtij fondi ka dhënë pasoja jo vetëm në investime të munguara në këtë fushë, por edhe në arritjen e objektivit kombëtar për reduktimin me 6.8% të kërkesave për energji deri në vitin 2020.

### **Rekomandim**

- Ministri i MIE të propozojë pranë Këshillit të Ministrave për miratim projekt-vendimin “Për Krijimin e Fondit për Eficiencën e Energjisë”.

**Dhjetor 2020**

### ***Mekanizmat financiarë***

Në Strategjinë Kombëtare për Energjinë 2018-2030 janë paraqitur një mori instrumentesh financiare, të cilët rekomandohen për të mbështetur zbatimin e qendrueshëm të PKVEE 2017-2020. Këto lloj stimulësh janë zbatuar nga shtetet

---

<sup>79</sup> Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara: “Financimi i eficiencës së energjisë dhe investimeve të energjisë së rinovueshme për zbutjen e ndryshimit të klimës”, 2018, fq. 43.

<sup>80</sup> Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara: “Mekanizmat e financimit të projekteve të eficiencës së energjisë në Ukrainë”, fq. 26.

anëtare të BE-së për të ndihmuar arritjen e synimeve të vendosura në PKVEE të ndryshme.<sup>81</sup> Në tabelën e mëposhtme paraqiten instrumentet financiare të rekomanduara për të nxitur investimet në EE dhe aplikimi i tyre në vendin tonë gjatë periudhës nën auditim.

**Tabela 10: Instrumentet financiare për nxitjen e investimeve në EE dhe aplikimi i tyre në Shqipëri**

	<b>Instrumenti financiar</b>	<b>Aplikimi</b>
1	Fondet qarkulluese	Jo.
2	Huat preferenciale	Jo.
3	Subvencionet	Jo.
	Garancitë e huave	Jo.
5	Asistencë teknike për përgatitjen e huave	Jo.
6	Financimi i palëve të treta	Nuk është aplikuar, subjekti është përgjegjës për grantet. <sup>82</sup>
7	Kontrata e performancës së energjisë	Jo.
8	Tregtimi (çertifikata energjetike).	Jo.

Burimi: SKE 2018-2030 dhe përgjigjet zyrtare të MIE  
Përpunoi: G.A

Mbështetur në përgjigjet zyrtare të subjektit, si dhe në praktikën e mira të konsultuara nga G.A (si p.sh. aplikimi i huave preferenciale në rastin e Ukrainës, garantimi i huave në rastin e Bullgarisë, etj.), një pjesë e konsiderueshme e mekanizmave financiare të mësipërme vihen në zbatim me funksionimin e Fondit të Eficiencës së Energjisë.

### Gjetje

- Në vendin tonë, përveç granteve, nuk është aplikuar asnjë instrument tjetër financiar për të mbështetur investimet në Eficiencën e Energjisë.<sup>83</sup>

### Konkluzion

- Si rezultat i mosaplikimit të instrumenteve financiare, alternativat e financimit për projektet në EE kanë qenë të kufizuara, çka ka ndikuar negativisht në sigurimin e fondeve të nevojshme për të zbatuar në mënyrë të qëndrueshme masat e parashikuara në PKVEE.

### Rekomandime

- MIE, në përmbushje të rekomandimit të dhënë në SKE 2018-2030, të ndërmerret masat e nevojshme për të aplikuar instrumentet financiare, me qëllim nxitjen e investimeve në eficiencën e energjisë.

<sup>81</sup> Strategjia Kombëtare për Energjinë 2018-2030, fq. 29.

<sup>82</sup> Shënim i G.A.

<sup>83</sup> Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018-2030, fq. 33.

### 3.2.2 A kanë arritur projektet e zbatuara në fushën e EE objektivat e parashikuara?

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë gjatë periudhës 2016-2019 ka mundësuar realizimin e disa projekteve në fushën e eficiencës së energjisë. Këto projekte janë financuar me fonde të brendshme ose me grante nëpërmjet donacioneve të huaja si fondet IPA etj. Për të patur një panoramë sa më të gjerë e të plotë lidhur me përfitimet e këtyre projekteve, grupi i auditimit përzgjedhi **tre projekte**<sup>84</sup> si raste studimore (case study) për t'i analizuar nëse objektivat e parashikuara në termat e tyre të referencës janë arritur apo jo dhe nëse këto objektiva mund të ishin më cilësore dhe më të matshëm. Për vlerësimin e cilësisë së tyre janë përdorur praktika të mira nga auditime të ngjashme të Gjykatës Evropiane të Llogarive e cila në 10-vjeçarin e fundit ka kryer disa auditime performance me fokus eficiencën e energjisë. Një ndër kriteret kryesore në përzgjedhjen e projekteve nga grupi i auditimit ishte se këto projekte duhej të ishin realizuar e përfunduar brenda periudhës së auditimit (2016-2019), çka do të mund të na lejonte në gjenerimin e gjetjeve dhe konkluzioneve se çfarë ka shkuar mirë e çfarë jo. Më poshtë po japim një përshkrim të shkurtër për secilin projekt të përgjedhur si rast studimor në këtë auditim.

#### Projekti GALET

Kontrata e Projektit GALET<sup>85</sup>, e cila parashikonte rinovimin e tre ndërtesave (Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastër, Biblioteka Korçë) është nënshkruar në 31 gusht 2016. Përfundimi i rinovimit të këtyre tre godinave ka qenë me afat deri në 28 shkurt 2017. Vlera monetare e kësaj kontrate ka qenë 143,354,294 lekë pa TVSH. Vlera e TVSH-së e cila është paguar nga buxheti i shtetit ka qenë 28,670,858 lekë. Projekti parashikonte rehabilitimin e tre godinave të trashëgimisë kulturore në Shqipëri (**Bashkia Vlorë, Gjirokastër dhe Biblioteka e Qytetit të Korçës**). Qëllimi i tij ishte kontributi në mbrojtjen e klimës dhe mjedisit nëpërmjet përdorimit eficient të energjisë dhe miqësore me mjedisin. Projekte të eficiencës së energjisë përfshijnë: ndërhyrje për zëvendësimin e sistemeve dhe pajisjeve ekzistuese me sisteme dhe pajisje të reja që synojnë përmirësimin e eficiencës së energjisë, reduktojnë humbjet energjitike duke sjellë përfitime ekonomike dhe mjedisore. Objektivi kryesor i projektit ishte identifikimi i masave të nevojshme lidhur me eficiencën e energjisë

---

<sup>84</sup> Shënim: Nga këto tre projekte, Projekti GALET është i vetmi i financuar nëpërmjet granteve, ndërsa dy të tjerët janë financuar nga buxheti i shtetit.

<sup>85</sup> i mbështetur në VKM nr. 561 datë 03.07.2013, Për miratimin në Parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi Shqipëri, për vitet 2012 dhe 2013, të komponentit të Dytë të Instrumentit të Para-antarësimit, IPA – Bashkëpunimi Ndërkufitar për Shqipërinë me objekt “Masat e Integruara të Eficiencës së Energjisë në 3 ndërtesa trashëgimi kulturore në Shqipëri (Bashkia Vlorë, Gjirokastër dhe Libraria e Qytetit të Korçës)”

dhe përllogaritja e kursimeve të energjisë në mënyrë që të përzgjidhen masat e eficiencës së energjisë me shkallën më të lartë të përfitimit. Grupi i auditimit në këtë projekt është fokusuar vetëm në objektivat që lidhen me kursimin e energjisë të parashikuara në Raportet e Auditimit Energjistik të cilët janë kryer për secilën prej tre godinave të sipërpërmendura.

### **Rinovimi i godinës së Bashkisë së Vlorës**

Në raportin e auditimit energjistik (pjesë e këtij projekti) për godinën e Bashkisë Vlorë është bërë një përshkrim i hollësishëm i gjendjes së saj para se ajo të rikonstruktohej me masa për eficiencën e energjisë. Nga ky auditim rezultoi se në godinën e Bashkisë së Vlorës kishte:

- Dëmtime nga lagështira për shkak të kapilaritetit të themeleve në katin e parë dhe kondensimit të ujit në hapsira të brendshme;
- Prani të lagështirës pranë dritareve për shkak të mos izolimit dhe krijimit të urave termike si dhe catisë në gjendje të keqe;
- Gjendje të keqe të tubave të shkarkimit të ujërave të shiut;
- Mure pa termoizolim dhe shpesh me suva të plasaritur;
- Disa lloje dritarësh si për shembull dritare me kornizë alumini dopio xham, dritare me kornizë PVC (plastikë) me dopio xham, dritare me kornizë prej druri me xham tek etj. Instalimi dhe performanca energjitike e këtyre dritareve ishte në gjendje shumë të keqe;
- Tualete me ventilim natyral, ku si rezultat i mos termoizolimit kishte prani të lagështisë;
- Sistem të vjetër të shkarkimit të ujërave të ndotura dhe sanitare;
- Sistem elektrik dhe të ndricimit në gjendje të keqe;
- Sistem të dobët të ngrohjes/ftohjes. Sistemi i ngrohjes/ftohjes bazohet në kondicionerë “*mono-split*” (që ndizen dhe fiken secili më vehte) dhe në disa ambiente ata mungojnë plotësisht. Për këtë arsye një pjesë e personelit të Bashkisë Vlorë përdorin pajisje të ndryshme elektrike për t’u ngrohur.
- Mungesë të ujit të ngrrohtë.

**Foto 1. Bashkia e Vlorës**



*Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bashkisë Vlorë*

**Foto 2: Pamje nga prania e lagështisë në godinën e Bashkisë Vlorë**



*Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bashkisë Vlorë*

**Foto 3: Pamje nga plasaritja e mureve në godinën e Bashkisë Vlorë**



*Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bashkisë Vlorë*

**Tabela 11. Përmbledhje e masave të EE – Bashkia Vlorë**

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Cmimi për njësi (€/m <sup>2</sup> )	Kosto e Investimit	Kursimi vjetor i energjisë (kWh/vit)	Kursimi vjetor (€)	Periudha e vetshlyerjes (vitet)
1	Termo izolimi i katit përdhe	m <sup>2</sup>	131	8	1,048	500.2	60	17.5
2	Termo izolimi i tarracës	m <sup>2</sup>	212.1	8	1,696.5	12,534.1	1,504.1	1.1
3	Termoizolimi i çatisë	m <sup>2</sup>	690.0	8.0	5,520.0	21,623.6	2,594.8	2.1
4	Zëvendësimi i dritareve	m <sup>2</sup>	224.4	220.0	49,378.8	24,498.3	2,939.8	16.8
5	Sistem qendror VRF <sup>86</sup> i ngrohje/ftohje	m <sup>2</sup>	2880	53	152,640	16,618.5	1,994.2	76.5
6	Ndriçimi me llampa LED	kompl	1.0	7,199	7,199	5,921.4	710.6	10.1
<b>Totali</b>					<b>217,482.3</b>	<b>81,696.1</b>	<b>9,803.5</b>	<b>22.2</b>

Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bashkisë Vlorë

### Rinovimi i godinës së Bashkisë së Gjirokastrës

Raport i Auditimit Energjistik u realizua gjithashtu edhe për Bashkinë e Gjirokastrës në të cilin u evidentuan të njëjta problematika si në godinën e Bashkisë së Vlorës. Lagështia, plasaritja e mureve, mungesa e termoizolimit të mureve e çatisë, dritaret me cilësi të ulët të performancës së energjisë si dhe mungesa e një sistemi qendror ngrohje/ftohje përbënin situatën dhe realitetin e kësaj godine para se ajo të rinovohej me masa për eficiencën e energjisë.

<sup>86</sup> [https://en.wikipedia.org/wiki/Variable\\_refrigerant\\_flow](https://en.wikipedia.org/wiki/Variable_refrigerant_flow)

**Foto 4. Pamje nga Bashkia Gjirokastër**



Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bashkisë Gjirokastër

**Foto 5. Pamje nga prania e lagështisë në godinën e Bashkisë**



Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bashkisë

**Tabela 12. Përmbledhje e masave të EE – Bashkia Gjirokastër**

Nr .	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (€/m <sup>2</sup> )	Kosto e Investimit	Kursimi vjetor i energjisë (kWh/vit)	Kursimi vjetor (€)	Periudha e vetshlyerjes (vitet)
1	Termo izolimi i katit përdhe	m <sup>2</sup>	1023.1	25	25,576.6	30,130.0	3,615.6	7.1
2	Termo izolimi i tarracës	m <sup>2</sup>	400	12	4800	2,328.8	279.5	17.2

3	Termoizolimi i çatisë	m <sup>2</sup>	484	30	14,520	33,691	4,042.9	3.6
4	Zëvendësimi i dritareve	m <sup>2</sup>	216.6	220.0	47,655.3	15,532.9	1,863.9	25.6
5	Sistem qendror VRF i ngrohje/ftohje	m <sup>2</sup>	1333	52.5	70,000	16,336.5	1,960.4	35.7
6	Ndriçimi me llampa LED	kompl	1.0	2,014.5	2,014.5	2,032.7	243.9	8.3
<b>Totali</b>					<b>164,566.4</b>	<b>100,051.9</b>	<b>12,006.2</b>	<b>13.7</b>

Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bashkisë Gjirokastrë

## Rinovimi i godinës së Bibliotekës së Korçës

**Tabela 13. Përmbledhje e masave të EE – Bibliotekës Korçë**

Nr	Përshkrimi	Kosto e Investimit	Mirëmbajtja	Kursimi vjetor i energjisë (kWh/vit)	Kursimi vjetor (€)	Periudha e vetshlyerjes (vitet)	Kursimi i CO <sub>2</sub> (kg/vit)
1	Termo izolimi i mureve të jashtëm	35,666	0	108,650.6	13,038.1	2.74	26,619.4
2	Termo izolimi i tarracës	18,929.7	0	75,797.6	9,095.7	2.08	18,570.4
3	Termoizolimi i katit përdhe	5,929.9	0.0	6,207.3	744.9	7.96	1,520.8
4	Zëvendësimi i dritareve	134,838.7	0.0	136,170.4	16,340.5	8.25	33,361.8
5	Sistem qendror ngrohje/ftohje	118,125.0	2,362.5	116,139.7	13,936.8	8.48	28,454.2
	Sistem ventilimi për katin nën tokë	21,000.0	840.0	32,555.2	3,906.6	5.38	7,976.0
	Ndriçimi me llampa LED	22,995.0	919.8	32,477.2	3,897.3	5.9	7,956.9
6	Sistem menaxhimi i ndërtesës	45,000.0	1,800.0	22,007.3	2,640.9	17.04	5,391.8
	<b>Totali</b>	<b>402,484.3</b>	<b>5,922.3</b>	<b>530,005.4</b>	<b>63,600.6</b>	<b>6.38</b>	<b>129,851.3</b>

Burimi: Raport i Auditimit Energjistik për godinën e Bibliotekës Korçë

## **Projekti “Auditimi Energjetik i Ndërtesave Publike”**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në rolin e Autoritetit Kontraktor me anë të kontratës me nr. Prot. 9732/7 datë 19.10.2018 ka mundësuar realizimin e projektit “Auditimi Energjetik i Ndërtesave Publike”. Ky projekt me afat 90 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të tij ka patur disa objektiva ku ndër më të rëndësishmit mund të përmendim:

- Inventarizimi i të gjitha aseteve në formën e ndërtesave që i përkasin qeverisjes qendrore dhe lokale,
- Krijimin e tabelave vlerësuese (template) mbi gjendjen e ndërtesave publike duke konsideruar sa më poshtë:
  - Klasifikimi i stokut të ndërtesave publike ekzistuese në Shqipëri.
  - Tipet referente dhe më përfaqësuese të stokut të ndërtesave publike në Shqipëri.
  - Struktura e stokut të ndërtesave publike sipas tipeve të tyre.
  - Për secilin tip përfaqësues të ndërtesave, auditimin e detajuar për të paktën 60 ndërtesa publike përfaqësuese, duke analizuar nëpërmjet auditimit energjetik:
    - sa është kërkesa për energji në kushtet aktuale dhe ato standarde;
    - energjia e furnizuar prej llojeve të burimeve të energjisë;
    - energjia primare dhe fundore e konsumuar dhe shkarkimet e CO<sub>2</sub> sipas energjisë së harxhuar për ngrohjen/ftohjen e sipërfaqes që trajtohet apo duhet trajtuar për një jetesë normale/standarde, ngrohjen e ujit, ftohjen e hapësirës dhe ventilimin.<sup>87</sup>

Nga zbatimi i kësaj kontrate në vitin 2018 është kryer auditimi energjetik për 60 godina të ndryshme sipas 6 tipeve përfaqësuese të stokut të ndërtesave publike:

- Spitale
- Konvikte
- Shkolla
- Kopshte dhe çerdhe
- Universitete
- Ndërtesat e institucioneve publike (bashkiake dhe qeveritare)

*Auditimi i energjisë konsiston në ekzaminim të detajuar të përdorimit të energjisë në objekt, çfarë paguan ky objekt për energjinë e konsumuar dhe një program me rekomandime për ndryshimet në funksionim dhe pajisjet që konsumojnë energji, të cilat do të kursejnë para në faturat e energjisë. Auditimi i energjisë quhet edhe vëzhgim energjetik ose analizë energjetike, në mënyrë që të mos pengohet nga ngjyrimet negative të një auditimi. Qëllimi i auditimit të energjisë, kompleksiteti i llogaritjeve dhe niveli i vlerësimit ekonomik janë të gjitha çështje që mund të përballen në mënyra të*

---

<sup>87</sup> Termat e Referencës për Projektin “Auditimi Energjetik i Ndërtesave Publike”, fq. 2

ndryshme nga auditues të ndryshëm dhe duhet të cilësohen prioritare për çdo fillim të aktivitetit të auditit. Auditimi i energjisë përfshin kontrollin sistematik të konsumit të energjisë nga pajisjet ose sistemet e instaluar që i shërbejnë ndërtesës, në mënyrë që të identifikohen mundësitë e menaxhimit të energjisë. Ky informacion i shërben pronarit të ndërtesës ose ndërmarrjes për të krijuar një panoramë mbi konsumin e energjisë, si dhe për ndërhyrjet në aplikimin e metodave dhe masave për të ruajtur dhe shfrytëzuar me eficiencë energjinë. Këto informacione ose ndërhyrje sjellin përfitime ekonomike, ambientale, etj. Auditimi i energjisë përcaktohet si proces i përcaktimit të pajisjeve, proceseve dhe kostos së përdorimit të energjisë në ndërtesa, duke vlerësuar ku përdoret energjia dhe duke identifikuar mundësitë për të reduktuar konsumin. Objektivi kryesor është të përcaktojë mënyra për reduktimin e konsumit të energjisë për njësi të produktit të prodhuar ose të zvogëlojë kostot operative.<sup>88</sup>

### **Projekti “Software për certifikimin energjistik të ndërtesa dhe regjistrimin e certifikatës PEN (Software PEN)**

MIE në rolin e Autoritetit Kontraktor ka nënshkruar kontratën “Software për certifikimin energjistik të ndërtesa dhe regjistrimin e certifikatës PEN” me operatorët ekonomikë “A-T-D Albania Technology Distribution” dhe “CREATX” me nr. Prot. 5663/7 datë 18.12.2017 ku është mundësuar realizimi i projektit “Software PEN”.

Objektivi i përgjithshëm i projektit të “Software PEN” ishte që të realizoheshin të paktën 65,000 auditime energjitike deri në vitin 2019 si dhe të jepeshin 25,000 certifikata të auditimit energjistik në vit. Produktet kryesore që duhet të arriheshin nga kontraktori janë si më poshtë:

- Ndërtim, Instalim, setup, konfigurim, testim dhe vënie në punë të Software për aplikimet on line për certifikimin energjistik të ndërtesave;
- Sigurimi i manualit në gjuhën shqipe sipas zbatimit që do të bëhet në këtë projekt;
- Zhvillimin e trajnimeve për të gjithë stafin që do të përdorë këtë sitem.

#### *Grupet e synuara për përdorimin e Software PEN*

1. *Përdoruesi “Institucioni përgjegjës”* - është Agjencia për Eficiencën e Energjisë qëllimi i së cilës është të përcaktojë parametrat dhe llogaritjet që përdoruesit profesionistë të autorizuar do të përdorin në llogaritjet e tyre nëpërmjet programit (Software PEN). Përdoruesit në AEE që do të kenë akses në parametrat e sistemit të menaxhimit, në funksionet e llogaritjes që do të përdoren nga profesionistët (audituesit energjistikë) janë vetëm punonjësit e autorizuar nga titullari i AEE.
2. *Përdoruesi profesionist* - i certifikuar si Auditues Energjistik për ndërtesat është një përdorues që përdor sistemin (Software PEN) për të kryer llogaritjet që do

---

<sup>88</sup> Raport Përmbledhës “Auditimi Energjistik i Ndërtesave Publike”, 6D-PLAN & CREATX, 2018, fq 16.

të përdoren në një projekt të auditimit të energjisë në ndërtesë. Përdoruesit e licensuar si Auditues energjistikë nuk mund të modifikojnë parametrat e përdorur në llogaritje por mund të kenë akses në mekanizmat e llogaritjes nëpërmjet futjes së të dhënave (input). Përdoruesi profesionist përfaqëson një përdorim (*username dhe password*) që mund të aksesojë sistemin.

3. *Administratorët e sistemit* – janë përdorues që menaxhojnë sistemin nga pikëpamja informatike, për shembull për krijimin e tipeve të rinj të përdoruesve me avantazhe specifike, ose duke mirpmbajtur parametrat e sistemit duke ndërhyrë vetëm në pjesë informatike (*memoria cache, numri i akseseve të njëkohshme* etj.).
4. *Përdoruesi i plotë* - përfaqëson një përdorues që ka licencë që i lejon veprimin e plotë në sistem.
5. *Operatori* - është ai që menaxhon sistemin, për shembull duke aktivizuar ose c’aktivizuar licensat e përdoruesve të lidhur me sistemin.<sup>89</sup>

## Gjetje

- MIE nuk ka të dhëna mbi sipërfaqen totale të ndërtesave publike të rikonstruktuar gjatë periudhës 2016-2019 lidhur me eficiencën e energjisë.
- MIE nuk ka të përcaktuar një maksimum të periudhës së vetëshlyerjes për aprovimin e investimeve në eficiencën e energjisë.<sup>90</sup>
- Projekti GALET nuk ka të përcaktuar objektiva që lidhen me çmimin njësi për energji të kursyer.
- Në projektin GALET nuk është realizuar auditim energjistik pas rinovimit të tre godinave (Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastër, Biblioteka Korçë) sepse nuk ka qenë e detyrueshme në kushtet kontraktuese.
- Raportet e auditimit energjistik për godinat e Bashkisë Vlorë, Gjirokastër dhe Bibliotekës së Korçës janë kryer në tetor 2016, ndërkohë rinovimi ka filluar në gusht 2016.
- Struktura menaxhuese e projektit “Auditimi energjistik i stokut të ndërtesave publike” nuk është krijuar në përputhje me termat e referencës.
- Software PEN që nga momenti i përfundimit të projektit e deri më sot nuk është vënë në përdorim.
- Objektivi i projektit PEN për realizimin e 65,000 auditimeve energjitike deri në 2019 nuk është arritur.
- Deri në vitin 2019 nuk është dhënë asnjë certifikatë nëpërmjet Software PEN.
- Projekti i Software PEN nuk ka mundur realizimin e trajnimeve për stafin që do ta përdorë atë.

---

<sup>89</sup> Termat e Referencës - Projekti “Software për certifikimin energjistik të ndërtesa dhe regjistrimin e certifikatës PEN

<sup>90</sup> Cost-effectiveness of Cohesion Policy Investments in Energy Efficiency, ECA 2012, paragraph 23.

## Konkluzione

- Edhe pse MIE ka mundësuar realizimin e disa projekteve dhe investimeve në rikonstruksionin/rinovimin e disa ndërtesave publike gjatë periudhës 2016-2019, ajo nuk ka të dhëna mbi sipërfaqen totale të ndërtesave publike të rinovuara. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur në dhënien e një konkluzioni të saktë nëse objektivi i PKVEE 2017-2020 për rinovimin e ndërtesave publike me 2 % në vit është arritur apo jo.
- Kriteret përzgjedhëse të projekteve/investimeve në eficiencën e energjisë duhet të garantojnë se mbështetja/aprovimi bëhet për ato projekte që janë me kosto efektive të lartë. Duke qenë se MIE nuk ka të përcaktuar në kriteret e veta përzgjedhëse një maksimum të periudhës së vetëshlyerjes për aprovimin e investimeve në eficiencën e energjisë, kjo ka çenuar në përzgjedhjen e projekteve kosto-efektive. Edhe pse në raportet e auditimit energjistik për godinat e Bashkisë Vlorë, Gjirokastër dhe Bibliotekës së Korçës është përcaktuar periudha e vetëshlyerjes e cila varion nga 13-22 vjet, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficiencës së Energjisë dhe Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Fushën e Industrisë dhe Energjisë nuk kanë përcaktuar se sa duhet të jetë kjo periudhë. Vendosja e një kufiri tavan të periudhës së vetëshlyerjes lehtëson vendimmarrjen për mbështetjen, aprovimin apo miratimin e projekteve në fushën e eficiencës së energjisë.
- Projekti GALET nuk ka patur objektiva racional për sa i përket efektivitetit të koston, si për shembull **kostoja për njësi e energjisë së kursyer**. Objektivat e tij ishin kursimi i energjisë dhe përmirësimi i komoditetit, por mbështetja e MIE ndaj këtij projekti dhe përzgjedhja për financim nga fondet IPA nuk është bërë në bazë të potencialit të tij për të prodhuar përfitime financiare përmes kursimit të energjisë, duke kompensuar kështu shpenzimet e bëra.
- Praktikrat e mira ndërkombëtare tregojnë se investimet në rikonstruksionin/rinovimin e ndërtesave lidhur me masat për përmirësimin e eficiencës së energjisë duhet të shoqërohen me auditime energjitike para dhe pas rinovimit.<sup>91</sup> Në projektin GALET nuk është realizuar auditim energjistik pas rinovimit të tre ndërtesave për të parë nëse objektivat e eficiencës së energjisë (të parashikuar në Raportet e Auditimit Energjistik të realizuara para fillimit të punimeve) janë arritur apo jo.
- Një auditim i energjisë përfshin zhvillimin bazë se si përdoret energjia, vlerësimin e kursimit potencial të energjisë dhe të kosto-efektivitetit të masave të përzgjedhura për kursimin e energjisë dhe **duhet të kryhet para marrjes së vendimit të financimit**.<sup>92</sup> Në rastin e Projektit GALET, marrja e vendimit (nënshkrimi i kontratës) është bërë dy muaj përpara (31 Gusht 2016) se të

---

<sup>91</sup> Cost-effectiveness of Cohesion Policy Investments in Energy Efficiency, ECA 2012, paragraph 43.

<sup>92</sup> Cost-effectiveness of Cohesion Policy Investments in Energy Efficiency, ECA 2012, paragraph 41.

përfundonin raportet e auditimit energjistik për të tre godinat (Bashkia Vlorë, Bashkia Gjirokastrë dhe Biblioteka Korçë), të cilat kanë përfunduar në Tetor 2016. Nënshkrimi i kontratës përpara se të përfundonin raportet e auditimit energjistik tregon se ky projekt nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur kritereve të kursimit të energjisë, periudhës së vetshlyerjes etj.

- Në nënkapitullin “Menaxhimi i projektit” të Termave të Referencës të Projektit “Auditimi energjistik i stokut të ndërtesave publike” është theksuar se Autoriteti Kontraktor (MIE) do të emëronte një njësi të menaxhimit të projektit sipas një strukture menaxhuese. Struktura menaxhuese do të përbëhej nga Drejtoresha e AEE-së, Drejtori i Drejtorisë së Politikave Energjitike në MIE, specialistë teknikë, financiarë etj. Urdhëri i Sekretarit të Përgjithshëm të MIE z. Gentian Këri me nr. 9732/9 datë 23.10.2018 “Për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës si dhe marrjen në dorëzim të produktit për tenderin me objekt Auditimi energjistik i stokut të ndërtesave publike” ka përcaktuar grupin e punës (strukturën menaxhuese) të përbërë vetëm nga specialistë të MIE, duke mos përfshirë Drejtoreshën e AEE-së dhe Drejtorin e Drejtorisë së Politikave Energjitike në MIE.
- Edhe pse Software PEN është ndërtuar dhe madje ka marrë edhe miratimin e AKSHI<sup>93</sup> (Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit) ai nuk është vënë asnjëherë në përdorim. Arsyet kryesore të mos vënies në përdorim janë Mungesa e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa si dhe mungesa e audituesve të çertifikuar të energjisë (përgjatë periudhës nën auditim).
- Mos vënia në përdorim e Software PEN ka ndikuar në mos arritjen e objektivave kryesore të këtij projekti si realizimi i 65,000 auditimeve energjitike deri në 2019 dhe lëshimi i çertifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa.
- Realizimi i trajnimeve për stafin që do të përdorë Software PEN ka qenë një tjetër objektiv i rëndësishëm i këtij projekti i cili nuk është përmbushur.

## **Rekomandime**

- MIE (në bashkëpunim me AEE) të sigurojë të dhëna të sakta mbi sipërfaqen totale të ndërtesave publike të rikonstruktuar gjatë periudhës 2016-2019 dhe në vazhdim lidhur me eficiencën e energjisë.

**Dhjetor 2020**

- MIE të marrë masa për të përcaktuar një maksimum të periudhës së vetshlyerjes për aprovimin/miratimin e projekteve/investimeve në eficiencën e energjisë.

**Dhjetor 2020**

---

<sup>93</sup> Kthim përgjigje me nr. prot. 1941/2 datë 16.06.2017 “Mbi kërkesën për miratim të projektit “Software për çertifikimin energjistik të ndërtesave dhe regjistrimin e çertifikatës PEN.

- MIE të marrë masa që çdo projekt/investim (lidhur me rinovimin e ndërtesave publike) që do të mbështesë në vazhdimësi të ketë të përcaktuar objektiva që lidhen me çmimin njësi për energji të kursyer.

#### **Në vazhdimësi**

- MIE të marrë masa që çdo projekt/investim (lidhur me rinovimin e ndërtesave publike) që do të mbështesë në vazhdimësi të ketë të përcaktuar në kushtet kontraktuese realizimin e auditimeve energjitike para dhe pas rinovimit të ndërtesave.

#### **Në vazhdimësi**

- MIE të marrë masa për zbatimin e termave të referencës së çdo projekti të cilin realizon.

#### **Në vazhdimësi**

- Pas miratimit të Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes (MKLL) së performancës së energjisë në ndërtesa dhe çertifikimit të audituesve të çertifikuar të energjisë MIE (në rolin e Autoritetit Kontraktor) dhe AEE në rolin e Institucionit e “Përdoruesit” të këtij sistemi të bashkëpunojnë për vënien në përdorim të tij.

#### **3 muaj pas miratimit me VKM të MKLL dhe çertifikimit të audituesve të energjisë**

- MIE të kërkojë nga Kontraktori realizimin e trajnimeve për stafin që do të përdorë Software PEN.

**Dhjetor 2020**

## **4. PËRMBLEDHJE**

Në këtë auditim jemi përqendruar në analizimin e efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi dhe politikave që synojnë përdorimin eficient të energjisë. Fokusi i auditimit krahas shqyrtimit në tërësi të zbatimit të politikave qeveritare lidhur me eficiencën e energjisë ka qenë veçanërisht në sektorin e ndërtesave duke qenë se mundësitë për kursimin e energjisë në ndërtesa janë tepër të larta dhe ndikimi në shëndetin e popullatës lidhet ngushtë me marrjen e masave të përmirësimit të performancës së energjisë në ndërtesa. Auditimi me temë “Eficiencia e Energjisë” shtrihet në periudhën **2016–2019** dhe synon të analizojë efektivitetin e institucioneve subjekt auditimi të cilat janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë nxitjen dhe përdorimin eficient të energjisë. Ky auditim ka për qëllim të ofrojë një tablo të qartë mbi integritetin, besueshmërinë, transparencën dhe efektivitetin e projekteve të eficiencës së energjisë të mbështetura nga qeveria shqiptare për të parë nëse këto projekte kanë sjellë përfitimet e pritshme për përfituesit dhe përdoruesit finalë. Subjektet e përfshira në këtë auditim janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia e Eficiencës së Energjisë.

Masat e marra nga MIE dhe AEE lidhur me eficiencën e energjisë në vendin tonë nuk kanë qenë efektive. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duke mos miratuar një sërë aktesh nënligjore ka dështuar të plotësojë Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e

Energjisë” dhe Ligjin nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa”. Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes nuk është miratuar me VKM. MIE nuk ka hartuar Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave Publike dhe Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji" si pjesë e PKVEE 2017-2020. AEE nuk ka monitoruar PKVEE 2017-2020 dhe Ministri i MIE nuk ka raportuar asnjëherë në Këshillin e Ministrave mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë. Si rezultat i mungesës së MKLL dhe audituesve energjitikë të çertifikuar nga AEE, deri më sot nuk është kryer asnjë auditim energjitik. Mosfunksionimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë ka cënuar financimin e programit në fushën e eficiencës së energjisë, zhvillimin e projekteve pilot për të studiuar teknologji të reja, kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e EE, ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese, zhvillimin e mekanizmave financiar dhe fiskal për nxitjen e investimeve. Projektet e audituara në këtë auditim nuk kanë arritur objektivat e tyre kryesore. Pavarësisht situatës aktuale, AEE gjatë gjashtë muorit të parë të 2020 ka hartuar dhe dërguar për miratim në MIE një sërë aktesh nënligjore. Miratimi i këtyre akteve, së bashku me zbatimin e rekomandimeve të lëna në këtë auditim subjekteve të audituara, do të sillte përmirësim në zbatimin e masave të eficiencës së energjisë.

“Metodologjia Kombëtare e Llogaritjes” (MKLL) së performancës së energjisë së ndërtesave nuk është e miratuar me VKM. MKLL si një dokument mjaft i rëndësishëm për llogaritjen e performancës së integruar të energjisë në ndërtesa me qëllim vlerësimin dhe plotësimin e çertifikatave të performancës së energjisë, duhet të përdoret për vlerësimin e niveleve të kostos optimale, masave të eficiencës së energjisë dhe energjisë primare të nevojshme gjatë ciklit ekonomik afatgjatë të konsumit të energjisë. Konceptet bazë të të dhënave nga MKLL ndihmojnë në ndërtimin dhe funksionimin e programit kompjuterik në lëshimin e çertifikatës së performancës së energjisë. Mungesa e MKLL dhe një programi kompjuterik të miratuar sjell dështimin e procesit të auditimit energjitik.

Kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave nuk janë miratuar me VKM sepse AEE për periudhën 2016-2019 nuk ka hartuar kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave. Hartimi dhe miratimi i kërkesave minimale të performancës së energjisë kanë për qëllim arritjen e niveleve të konsumit energjetik optimal të ndërtesave. Këto kërkesa marrin parasysh kushtet e përgjithshme të brendshme klimaterike, në mënyrë që të shmangin efekte negative të mundshme siç mund të jetë ventilimi i papërshtatshëm, kushtet lokale, funksionet e caktuara dhe moshën e ndërtesës. Mungesa e miratimit të kërkesave minimale të performancës së energjisë ndikon negativisht në performancën energjitike të ndërtesave. Drafti me kërkesat minimale të performancës së energjisë së ndërtesave është hartuar dhe dorëzuar nga AEE në MIE më datë 14.05.2020 jashtë afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 116/2016 për “Performancën e Energjisë së Ndërtesave” neni 16 pika 1. MIE nuk ka hartuar Strategjinë për Rinovimin e Ndërtesave Publike dhe nuk ka miratuar Planin Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me

performancë "afër zero energji" si pjesë e PVKEE. Mungesa e Strategjisë për Rinovimin e Ndërtesave Publike dhe Planit Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji" bën të pamundur zbërthimin në hapa konkrete të aktiviteteve që duhen ndërmarrë lidhur me këto dy çështje. Për periudhën 2016-2019 Ministri i MIE nuk ka miratuar Rregulloren e hartuar nga AEE "Për formatin e auditimit energjistik dhe pagesën për audituesin energjistik". Rregullorja e formatit të auditimit energjistik dhe pagesave për audituesin energjistik është hartuar nga AEE dhe është dërguar për miratim në MIE me shkresën me nr. Prot. 80 datë 15.05.2020. Afati për miratimin e kësaj rregulloreje ka qenë 25.11.2017. Kjo rregullore ndihmon në parandalimin e abuzimeve që çdo person, subjekt i auditimit energjetik, paguan ndaj shpenzimeve të kryera nga audituesit energjistikë, si dhe shpenzimet për zbatimin e masave të dhëna nga audituesi për kursimin e energjisë.

AEE është institucioni përgjegjës për të monitoruar dhe raportuar në MIE mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit të Eficiencës së Energjisë. Që nga momenti i themelimit të AEE-së e deri në 2019, ajo asnjëherë nuk ka monitoruar dhe raportuar në MIE mbi zbatimin e masave dhe objektivave të vendosura në PKVEE 2017-2020. Formatin mbi mënyrën e raportimit të AEE-së në MIE nuk është miratuar me Urdhër të veçantë nga Ministri i MIE dhe kjo është një nga shkaqet kryesore të mos raportimit. Mungesa e realizimit të auditimeve energjitike (për periudhën 2016-2019) në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë" i *ndryshuar*, ka ardhur si rezultat i mungesës së Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes për performancën energjitike të ndërtesave si dhe mungesës së audituesve energjistikë të certifikuar. Mungesa e auditimeve energjitike sjell mangësi dhe në rritjen e standarteve të performancës në auditimin e energjisë në ndërtesa nëpërmejt një vlerësimi të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik. Vlen për t'u përmendur se AEE ka realizuar testimin e parë për certifikimin e audituesve energjistikë në 22.05.2020 dhe shumë shpejt pritet pajisja e audituesve energjistikë me certifikata. Faturimi informativ, fushatat e ndërgjegjësimit, edukimi dhe trajnimi për eficiencën e energjisë janë disa nga masat kryesore lidhur me kursimin e energjisë të cilat janë përgjegjësi direkte e AEE-së referuar PKVEE 2017-2020 (fq. 110). Faturat duhet të përmbajnë krahasime, në formë grafike, të konsumit në periudhën e faturimit të vitit aktual dhe konsumit në periudhën korresponduese të vitit të mëparshëm. Faturat duhet të bazohen në konsumin aktual dhe duhet të përmbajnë informacion se ku mund të merren këshilla për konsumin e energjisë në mënyrë eficiente, duke vendosur një numër telefoni jeshil (pa pagesë). AEE nuk ka ndërmarrë asnjë masë lidhur me faturimin informativ si dhe fushatave të ndërgjegjësimit dhe informimit të konsumatorëve fundorë. AEE bazuar në Ligjin nr. 124/2015 "Për Eficiencën e Energjisë" dhe Ligjin nr. 116/2016 "Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave" është institucioni publik i cili ka përgjegjësinë për vendosjen e sanksioneve kundrejt shkelësve të ligjeve të sipërcituar. Mos marrja e masave sanksionuese nga ana e AEE-së ka ardhur si rezultat i mos plotësimit të dy ligjeve të

përmendura më sipër me aktet nënligjore të përcaktuara në secilin prej tyre. Mungesa e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa, mungesa audituesve energjitikë të çertifikuar, mungesa e raporteve të auditimit energjitikë dhe mungesa e çertifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa (për periudhën objekt auditimi) janë disa nga pengesat kryesore që e bëjnë të pamundur aplikimin e kundravajtjeve administrative nga AEE.

Masat për të siguruar përparim në drejtim të përdorimit eficient të energjisë në vend, me qëllim për të arritur objektivin kombëtar të kursimit, nuk janë mbështetur me buxhetin e nevojshëm. Niveli i realizimit të buxhetit (faktik) gjatë periudhës nën auditim është në nivele të ulta, çka ka shkaktuar që, pavarësisht shtimit të masave të parashikuara për EE, buxheti i alokuar në vitin 2018 të ishte më i ulët, se ai i alokuar në vitin 2016. Fuksionimi i plotë i AEE-së, si një aktor kyç për zhvillimin dhe nxitjen e Eficiencës së Energjisë në vend, gjatë periudhës nën auditim nuk është trajtuar si prioritet kombëtar në aspektin financiar. Mbështetja me buxhet ka qenë e pamjaftueshme, duke cënuar efektivitetin dhe eficiencën e veprimtarisë së AEE-së.

Pamjaftueshmëria e fondeve të alokuara për AEE ka ndikuar në mosmbulimin e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të saj. Mosfukcionimi i Fondit ka cënuar financimin e programit në fushën e EE, zhvillimin e projekteve pilot për të studiuar teknologji të reja, kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e eficiencës së energjisë, ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuese, zhvillimin e mekanizmave financiar dhe fiskal për nxitjen e investimeve, etj. Si rezultat i mosaplikimit të instrumenteve financiare, alternativat e financimit për projektet në EE kanë qenë të kufizuara, çka ka ndikuar negativisht në sigurimin e fondeve të nevojshme për të zbatuar në mënyrë të qëndrueshme masat e parashikuara në PKVEE. Edhe pse MIE ka mundur realizimin e disa projekteve dhe investimeve në rikonstrukcionin/rinovimin e disa ndërtesave publike gjatë periudhës 2016-2019, ajo nuk ka të dhëna mbi sipërfaqen totale të ndërtesave publike të rinovuara. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pamundur në dhënien e një konkluzioni të saktë nëse objektivi i PKVEE 2017-2020 për rinovimin e ndërtesave publike me 2 % në vit është arritur apo jo. Kriteret përzgjedhëse të projekteve/investimeve në eficiencën e energjisë duhet të garantojnë se mbështetja/aprovimi bëhet për ato projekte që janë me kosto efektive të lartë. Duke qenë se MIE nuk ka të përcaktuar në kriteret e veta përzgjedhëse një maksimum të periudhës së vetëshlyerjes për aprovimin e investimeve në eficiencën e energjisë, kjo ka cënuar në përzgjedhjen e projekteve kosto-efektive. Edhe pse në raportet e auditimit energjitik (të Projektit GALET) për godinat e Bashkisë Vlorë, Gjirokastër dhe Bibliotekës së Korçës është përcaktuar periudha e vetëshlyerjes e cila varion nga 13-22 vjet, MIE nuk ka të përcaktuar se sa duhet të jetë kjo periudhë. Vendosja e një kufiri tavan të periudhës së vetëshlyerjes lehtëson vendimmarrjen për mbështetjen, aprovimin apo miratimin e projekteve në fushën e eficiencës së energjisë. Projekti GALET nuk ka patur objektiva racional për sa i përket efektivitetit të koston, si për shembull **kostoja për njësi e energjisë së kursyer**. Objektivat e tij ishin kursimi i energjisë dhe përmirësimi i komoditetit, por

mbështetja e MIE ndaj këtij projekti dhe përzgjedhja për financim nga fondet IPA nuk është bërë në bazë të potencialit të tij për të prodhuar përfitime financiare përmes kursimit të energjisë, duke kompensuar kështu shpenzimet e bëra. Edhe pse Software PEN (Projekti “Software për çertifikimin energjistik të ndërtesa dhe regjistrimin e çertifikatës PEN - Software PEN) është ndërtuar dhe madje ka marrë edhe miratimin e AKSHI ai nuk është vënë asnjëherë në përdorim. Arsyet kryesore të mos vënies në përdorim janë Mungesa e Metodologjisë Kombëtare të Llogaritjes së performancës së energjisë në ndërtesa si dhe mungesa e audituesve të çertifikuar të energjisë (përgjatë periudhës nën auditim). Mos vënia në përdorim e Software PEN ka ndikuar në mos arritjen e objektivave kryesore të këtij projekti si realizimi i 65,000 auditimeve energjitike deri në 2019 dhe lëshimi i çertifikatave të performancës së energjisë në ndërtesa.

Rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit janë dhënë specifikisht për secilin subjekt të audituar duke theksuar dhe kohën në të cilën duhen përmbushur. Rekomandimet e lëna nga grupi i auditimit për MIE dhe AEE janë dhënë në përshtatje me pyetjet audituese dhe më specifikisht rekomandime që kanë të bëjnë me hartimin (nga AEE dhe MIE), miratimin nga MIE (të atyre akteve nënligjore që janë detyrim i saj për t'i miratuar) si dhe propozimin për miratim në Këshillin e Ministrave të akteve të tjera. Rekomandime të tjera lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor janë dhënë si për MIE ashtu dhe për AEE në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Ligjin nr. 116/2016 për “Performancën e Energjisë së Ndërtesave” si dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2017-2020. Lidhur me mekanizmat financiar grupi i auditimit ka dhënë disa rekomandime ku ndër më kryesoret janë ata që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e FEE në përputhje me Ligjin nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Kreu V si dhe aplikimi i instrumenteve financiare të përcaktuara në SKE 2018-2030 me qëllim nxitjen e investimeve në eficiencën e energjisë. Rekomandimet e dhëna për projektet e realizuara/mbështetura nga MIE të përzgjedhura si “*case study*” nga grupi i auditimit janë bazuar në praktikat e mira të marra nga raportet e performancës të realizuara nga Gjykata Evropiane e Logarive vitet e fundit. Këto rekomandime synojnë përmirësimin e problematikave të evidentuara nga grupi i auditimit me qëllimin kryesor arritjen e objektivave të këtyre projekteve.

Pyetjet e piramidës	Përgjigja	Struktur a përgjegjëse
A janë të mjaftueshme dhe përshtatshme politikat për promovimin dhe përdorimin eficient të energjisë?	<b>JO.</b> Institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, duke mos miratuar një sërë aktesh nënligjore kanë dështuar në plotësimin e kuadrit ligjor për Eficiencën e Energjisë. MKLL nuk është miratuar me VKM. Nuk është hartuar Strategjia për Rinovimin e Ndërtesave Publike dhe Plani Kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me performancë "afër zero energji" si detyrimet kryesore për përmbushjen e masave në promovimin e EE.	MIE AEE
A është zbatuar kuadri ligjor/rregullator nga institucionet përgjegjëse lidhur me EE?	<b>JO.</b> AEE dhe MIE nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në zbatimin e tyre. Nuk janë zbatuar detyrimet për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të PKVEE 2017-2020. Si pasojë e mungesës së audituesve të certifikuar nuk janë kryer auditime energjitike dhe nuk janë lëshuar certifikata të performancës së energjisë.	MIE AEE
A ekzistojnë mekanizma financiare për të siguruar rritjen e Eficiencës së Energjisë?	<b>JO.</b> Masat për të siguruar përparim në drejtim të përdorimit eficient të energjisë në vend, me qëllim për të arritur objektivin kombëtar të kursimit, nuk janë mbështetur me buxhetin e nevojshëm. Mosfunksionimi i FEE ka çënuar financimin e programit në fushën e EE, zhvillimin e projekteve pilot për të studiuar teknologji të reja, kërkimin dhe zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e eficiencës së energjisë, ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuere, zhvillimin e mekanizmave financiar dhe fiskal për nxitjen e investimeve, etj.	MIE AEE
A kanë arritur projektet zbatuara në fushën e objektivat të EE të parashikuara?	<b>JO.</b> Projektet e përzgjedhura nuk kanë arritur objektivat e tyre. Për Projektin "GALET" duke qenë se nuk janë realizuar auditime energjitike <i>pas rinovimit</i> të tre ndërtesave askush nuk mund të garantojë nëse objektivat e vendosura në raportet e auditimit energjistik <i>para rinovimit</i> të tre ndërtesave janë arritur apo jo. Struktura menaxhuese për ndjekjen e Projektit "Auditimi i Stokut të ndërtesave" nuk ka respektuar termat e referencës. Projekti "Softwear PEN" nuk është vënë asnjëherë në përdorim si pasojë e mungesës së MKLL dhe audituesve energjistikë.	MIE

## ***ANEKSI I - Përdorimi i Fondit të Eficiencës së Energjisë në Evropë***

***Fondi për mbrojtjen e mjedisit dhe eficienten e energjisë***<sup>94</sup> në Kroaci u krijua në bazë të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjit të energjisë. Fondi është konceptuar si një fond jashtë-buxhetor, burimet e financimit të të cilët nuk sigurohen nga buxheti i shtetit. Fondet sigurohen nga taksat ambjentale. Fondi financon përgatitjen, zbatimin dhe zhvillimin e programeve, projekteve dhe aktiviteteve të ngjashme në fushën e EE dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

***Fondi i Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme***<sup>95</sup> në Bullgari është rezultat i një partneriteti publik, i cili ka aftësinë e kombinuar të një institucioni huadhënës, një strukturë të garantimit të kredisë dhe një kompani këshilluese. Ajo siguron asistencë teknike për institucionet private dhe publike bullgare në zhvillimin e projekteve të EE dhe mbështet financimin e tyre drejtpërdrejt ose duke vepruar si garant për financimet nga institucionet e tjera.

Republika e Serbisë ka krijuar ***Fondin Buxhetor për Eficienten e Energjisë (BFEE)***<sup>96</sup> në vitin 2014. BFEE është një linjë buxheti në buxhetin e Republikës së Serbisë, e menaxhuar nga Ministria e Minierave dhe Energjisë, e financuar përmes buxhetit të shtetit dhe donacioneve. Përfituesit mund të jenë persona juridikë dhe privatë. Ky fond jep financim përmes thirrjeve publike, në përputhje me programin vjetor të miratuar nga qeveria.

Themelimi i ***Fondit të EE***<sup>97</sup> në Ukrainë ka si qëllim thjeshtimin procedurat për mobilizimin e fondeve përdorimin e tyre për modernizimin e energjisë së ndërtesave të banimit dhe ato publike. Fondi financohet nga Buxheti i Shtetit të Ukrainës dhe nga donatorët. Fondi i Eficientes së Energjisë mund të japë mbështetje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të veprjë si garant tek banka. Ai financon projektet e përmirësimit të përdorimit të energjisë me anë të tre paketave (Paketa e Lehtë, Paketa *All-Inclusive* dhe Paketa Banese) ku secila prej tyre përcakton deri në çfarë niveli do të jetë financimi si dhe periudhën e pagesës nga përfituesit. Paraprakisht, në ndërtesë kryhet një auditim i energjisë, rezultatet e të cilit përcaktojnë se cila nga paketat është e përshtatshme për t'u përdorur.

---

<sup>94</sup> [http://www.fzoeu.hr/en/about\\_us/](http://www.fzoeu.hr/en/about_us/)

<sup>95</sup> Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara: "Financimi i eficientes së energjisë dhe investimeve të energjisë së rinovueshme për zbutjen e ndryshimit të klimës", 2018, fq. 43.

Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara: "Rast stufimore, OZHQ 7- Përmirësimi i eficientes së energjisë", fq. 2.

<sup>97</sup> Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara: Mekanizmat e financimit të projekteve të eficientes së energjisë në Ukrainë, Fq. 26

## ANEKSI II - Pyetësi "on-line" për Eficiencën e Energjisë


Grupi i auditimit hartoi një pyetësor për publikun e gjerë, i cili u shpërnda online për një periudhë 10 ditore. Krahas pyetjeve lidhur me konceptin e eficiencës së energjisë, pyetësi u ndërtua me pyetje të karakterit socio-ekonomik dhe shëndetësor për të parë më nga afër problematikat dhe masën e informimit të qytetarëve në rang republike për Eficiencën e Energjisë. Nga ky pyetësor u përfatuan 2399 përgjigje, të cilat më pas u përpunuan nga grupi i auditimit. Pyetësi përmban në total 20 pyetje. 37.8 % e përgjigjeve erdhën nga qytetarë të Qarkut të Tiranës, 11.8 % nga Qarku i Durrësit e me rradhë. Edhe pse 71.6 % e përgjigjeve erdhën nga persona me arsim të lartë, siç do ta shikojmë dhe më vonë gjatë shtjellimit të përgjigjeve të këtij pyetësi, vihet re mungesë informacioni lidhur me konceptin e eficiencës së energjisë. 47% e të anketuarëve jetojnë në ndërtesa të viteve 1991-2010 dhe 18 % në ndërtesa të viteve pas 2010.

Grupmosha kryesore që iu përgjigj këtij pyetësi ishte ajo 18-33 vjeç me 93 %, e ndjekur nga ajo 34-49 vjeç me 6%. 1/3 ose rreth 33% e të anketuarëve jetojnë në banesa me sipërfaqe 70-100 m<sup>2</sup>, 18 % në banesa me sipërfaqe 40-70 m<sup>2</sup>, 18 % në banesa me sipërfaqe 100-130 m<sup>2</sup> dhe pjesa tjetër në banesa me sipërfaqe mbi 130 m<sup>2</sup>. Nga përgjigjet e të anketuarëve "on line" rezultoi se 68.9% e tyre nuk kanë njohuri mbi konceptin e eficiencës së energjisë. 74 % e të anketuarëve u përgjigjën se disponojnë dritare alumini në banesat e tyre dhe pjesa tjetër dritare me korniza druri dhe plastike. 57.7 % e të anketuarëve jetojnë në banesa me dritare dopioxham, 35.1 në dritare me tek xham. Vendosja e dritareve me xham të dyfishtë ose të trefishtë shikohet si një masë e rëndësishme për përmirësimin e eficiencës së energjisë në ndërtesa. Nga përgjigjet rezultoi se 48.5% përdorin energjinë elektrike për t'u ngrohur, 41.7 % përdorin drurin për t'u ngrohur dhe pjesa tjetër gazin. 58.8% dëshmojnë se nuk janë të kënaqur me ruajtjen e temperaturës së brendshme të ambientit pas fikjes së pajisjeve ngrohëse apo ftohëse. Një tjetër tregues i rëndësishëm për gjendjen e banesave lidhet edhe me prezencën e lagështirës dhe mykut. 49.7 % kanë probleme me lagështirën, mykun etj. Pyetjes "Sa mendoni se gjendja juaj shëndetësore ndikohet nga kushtet e përgjithshme të banesës tuaj", 46.4% e të anketuarëve iu përgjigjën se gjendja e tyre shëndetësore ndikohet **shumë** nga kushtet e banesave të tyre. Edhe pse nga përgjigjet e të anketuarëve rezultoi se një pjesë e mirë e qytetarëve kanë marrë masa dhe iniciativa personale për përmirësimin dhe përdorimin eficient të energjisë, vihet re mungesë e institucioneve përgjegjëse në mbështetje ndaj këtyre iniciativave. 93.5% e të anketuarëve nuk kanë marrë njoftime apo informacione nga institucionet publike, mbi përfitimet që vijnë nga marrja e masave për të përmirësuar eficiencën e energjisë në banesat e tyre. Një tjetër çështje që u trajtua me mjaft rëndësi nëpërmjet ëyeteve në këtë pyetësor kishte

të bënte dhe me kursimin e enrgjisë pas marrjes së masave lidhur me përdorimin eficient të energjisë. Rreth 43 % e përgjigjeve deklarojnë se pas marrjes së masave për përdorimin eficient të energjisë, këto masa nuk kanë rezultuar në kursimin e energjisë dhe uljen e faturave energjitike. Më poshtë paraqiten grafikisht të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e këtij pyetëtori.


### 1. Qarku

2,399 responses




### 2. Moshë

2,399 responses




### 3. Arsimi

2,399 responses




### 4. Kur është ndërtuar banesa ku ju jetoni?

2,396 responses




### 5. Sa është sipërfaqja në metër katror e banesës tuaj?




### 6. Lutemi, shënoni cilat grupmosha jetojnë në shtëpinë tuaj.

2,365 responses




### 7. A keni njohuri mbi konceptin e Eficiencës së Energjisë?

2,399 responses




### 8. Çfarë materiali janë dritaret në shtëpinë tuaj?

2,399 responses




### 9. Çfarë përdorni për tu ngrohur në banesën tuaj?

2,399 responses




### 10. Prej sa shtresave xhami përbëhen dritaret në banesën tuaj?

2,399 responses




### 11. A jeni të kënaqur me ruajtjen e temperaturës në banesën tuaj pas fikjes së pajisjeve ngrohëse/ftohëse?

2,399 responses




### 12. A keni probleme në banesën tuaj lidhur me lagështinë, mykun, etj.?

2,399 responses




### 13. A keni dijeni se cilat janë masat kryesore që duhen ndërmarrë për ta bërë banesën tuaj më eficiente në përdorimin e energjisë?

2,391 responses




#### 14. A keni dijeni se cilat janë përfitimet kryesore të përdorimit eficient të energjisë?

2,371 responses




#### 15. Sa mendoni se gjendja juaj shëndetësore ndikohet nga kushtet e përgjithshme të banesës tuaj?

2,399 responses




#### 16. Cilat nga masat e mëposhtme keni aplikuar në banesën tuaj për ta bërë atë më eficiente në përdorimin e energjisë?

2,349 responses




### 17. Nëse keni ndërmarrë ndonjë prej masave të mësipërme, a kanë rezultuar në uljen e pagesave të faturave të energjisë elektrike?


2,284 responses



### 18. Sa është pagesa mesatare mujore për energjinë elektrike që shpenzon gjatë sezonit të dimrit?



**19. Sa është pagesa mesatare mujore për energjinë elektrike që shpenzon gjatë sezonit të verës?**



**20. A jeni njoftuar nga institucione të ndryshme publike mbi përfitimet që vijnë nga marrja e masave për të përmirësuar eficiencën e energjisë në shtëpinë tuaj?**

2,399 responses



**KONTROLLI I LARTË I SHITIT**